NDREQJE GABIMESH

Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare dhe Kent Bank A.S., miratuar me ligjin nr.8634, datë 6.7.2000, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.21, faqe 1014, ribotohet i plotë për shkak të disa mangësive dhe pasaktësive gjuhësore që lidhen me terminoligjinë e përkthimit në shqip.

Nr. Operacionit të BERZH 826

Nr. Investimit të KFN 9687

MARRËVESHJA E BLERJES SË AKSIONEVE

Ndërmjet

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Dhe

BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Dhe

KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Dhe

KENT BANK A.S.

8 Qershor 2000

MARRËVESHJA E BLERJES SË AKSIONEVE

MARRËVESHJE, e datës 8 Qershor 2000, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave ("Shitësi"), BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM ("BERZH"), KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBETARE ("KFN") dhe KENT BANK A.S. një shoqëri e organizuar, që ekziston dhe e licensuar si bankë në bazë të ligjeve të Republikës së Turqisë ("KB").

DUKE QËNE SE:

(A) Banka Kombëtare Tregtare Sh.A. është një shoqëri anonime e organizuar, që ekziston dhe e licensuar si bankë në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë ("Shoqëria").

(B) Kapitali aksioner aktual i autorizuar i Shoqërisë përbëhet nga 2,700,000,000 Lek i ndarë në 27,000 Aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 100,000 Lek secila, dhe të cilat janë të gjitha të emetuara, në qarkullim dhe në pronësi te Shitësit ("Aksionet Ekzistuese");

(C) Ne përputhje me Ligjet e Privatizimit, Shitësi synon të privatizojë Shoqërinë, përpara kësaj synon të ridenominojë kapitalin aksionar të shoqërisë dhe të riorganizojë bilancin e Shoqërisë;

(D) Në vijim të këtij ridenominimi dhe riorganizimi, kapitali aksionar i autorizuar i Shoqërisë do të jetë shuma prej 10,000,000 US$ dhe ekuivalentit në US$ në datën e ridenominimit të 2,700,000,000 Lekë (rrumbullakosur në me të afërtën e 10 US$) dhe e ndarë në Aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 10 US$ secila, nga të cilat 1,000,000 aksione të tilla do të jenë të

autorizuara por të paemetuara dhe pjesa e mbetur ("Aksionet e Shitjes") do të jenë të emetuara, në qarkullim, të paguara plotësisht dhe në pronësi të Shitësit;

(E) Me qëllim që të privatizojë Shoqërinë dhe në përputhje me Ligjin e Privatizimit dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, Shitësi dëshiron t'i shesë Aksionet e Shitjes Blerësve në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë të drejtën e Blerësve që t'ia rishesin Aksionet Shitesit në rrethana të caktuara të specifikuara.

PËR KËTO ARSYE TANI, Palët bien dakort si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Seksioni 1.01. Përkufizime

Kudo që perdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë Recitalet dhe Pasqyrat), përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat në vazhdim do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Çmimi i Blerjes"do të thotë: (a) në lidhje me Aksionet e Nënshkrimit, 10 milion USD; dhe
(b) në lidhje me shumën e të gjitha Aksioneve të Rishitjes të cilat nuk janë Aksione Nënshkrimi, shumën e çmimit paguar nga Blerësit për këto Aksione.

"Vlera Kontabël e Përshtatur" do të thotë vlerën e të gjithë aktiveve të Shoqërisë, minus të gjithë pasivet e Shoqërisë, siç tregohen edhe në Llogaritë Financiare deri në Datën e Transferimit (vërtetuar nga Auditorët), e përshtatur në mënyrë të tillë që të mos pasqyrojë Transhin e Dytë të Kredisë.

"Dokumentat Ndihmese" do të thotë këtë Marrëveshje, Statutin, Letrën e Informimit të Shoqërisë, dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave.

"Ligjet e Aplikueshme" do të thotë çdo akt ligjor kombëtar ose lokal të aplikueshëm, urdhëresë, dekret, ose ligj tjetër, rregullore ose akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose direktive, ose çdo liçensë, dhënie pëlqimi, leje, autorizim ose miratim tjetër duke përfshirë ndonjë kusht tjetër të bashkëngjitur aty (që ka ose jo lidhje me mjedisin) të Republikës së Shqipërisë ose të çdo pjese brenda saj ose të ndonje Enti Shtetëror ose personi me status ligjor (autonom ose jo) që ka juridiksion të aplikueshëm.

"Banka Arabo-Shqiptare Islamike" do të thotë shoqëria anonime me të njëjtin emër, e organizuar, që ekziston dhe e licensuar si bankë sipas Ligjeve të Aplikueshme.

"Auditorët" do të thotë një firmë e tillë ekspertësh kontabël të pavarur që Shoqëria mund të caktojë kohe pas kohe si auditorë të saj në përputhje me Seksionin 4.01.

"Autorizimi" do të thotë çdo aplikim apo pëlqim, leje, liçensë, koncesion, heqje, autorizim, miratim ose vërtetim, dhënia ose rinovimi i të cilave është në përgjegjësine e çdo burse aksionesh ose Enti Shteteror dhe që i kërkohet Shoqërisë ose secilës prej Palëve për kryerjen e Projektit, ose, në lidhje me çdo aktivitet përkatës të tyre në Republikën e Shqipërisë të parashikuar në këtë Marrëveshje, në ndonjë Dokument Ndihmës ose në Liçensën Bankare.

"Banka Italo-Shqiptare" do të thotë shoqëria anonime me të njëjtin emër, e organizuar, që ekziston dhe e licencuar si bankë sipas Ligjeve të Aplikueshme.

"Ligji Bankar"	do të thotë Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" nr. 8365, datë 2 Korrik 1998.
"Liçensa Bankare"	do të thotë liçensa e përgjithshme (no 6/1998) dhënë Shoqërisë me 11 Janar 1999 nga Banka e Shqipërisë.
"Banka e Shqipërisë "	do të thotë Banka e Shqipërisë e organizuar dhe që ekziston në baze të Ligjeve të Aplikueshme.
"Këshilli Drejtues"	do të thotë këshilli drejtues i Shoqërisë.
"Vlera Kontabël"	do të thotë vlera e të gjithë aktiveve të Shoqërisë, minus të gjithe pasivet e Shoqërisë, siç paraqiten në Llogaritë Financiare me të fundit të audituara, në datën e llogaritjes.
"Ditë Pune"	do të thotë çfarëdo dite (e ndryshme nga e Shtunë ose e Dielë) në të cilën bankat tregtare dhe tregjet e këmbimeve valutore janë të hapura për transkasionin e aktivitetit në tregun ndërbankar të Dollarit në Tiranë, Shqipëri, Londër, Angli dhe në New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
"Ndryshim në Ligj"	do të thotë dekretimi, miratimi, fillimi, revokimi, kthimi, modifikimi, ndryshimi ose abrogimi i çdo Ligji te Aplikueshëm ose Autorizimi që hyn në fuqi pas datës së kësaj Marrëveshjeje ose çdo ndryshim në interpretimin ose aplikimin e sa më sipër nga ndonjë Ent Shtetëror.
"Statut"	do të thotë dokumentat e themelimit të Shoqërisë që përfshijnë: aktin e themelimit, proces-verbalin e mbledhjes themeluese, vendimin e regjistrimit Nr. 17469 datë 23 Korrik 1997 dhënë nga Gjykata e Tiranës që krijon Shoqërine, dhe statutin e regjistruar në bazë të këtij vendimi (në përputhje me Ligjet e Aplikueshme).
"Shoqëria"	përcaktohet në Recitalin A.
"Letra e Informimit Shoqërisë"	do të thotë letra adresuar BERZH-it dhe KFN-se nga Shoqëria më datë 20 Janar 2000, që përmban deklarimet e Shoqërisë për sa i përket të gjitha fakteve materiale në lidhje me Projektin, organizimin, statusin, operacionet, pjesëmarrjet, pasivet dhe aktivet e Shoqërisë dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje dhe Dokumentet e tjera Ndihmëse (siç jane rifreskuar me shkrim në ose para datës së kësaj Marrëveshjeje).
"Date e Llogaritjes"	do të thotë; (a) ne lidhje me çdo Aksion Rishitjeje: (i) data e blerjes së një Aksioni të tillë të Rishitjes; dhe (ii) data e cila i bie të jetë gjashtë muaj pas një date të tillë blerjeje; (b) në lidhje me Pagesat e Dividendeve: (i) data e pagesës së një dividendi të tillë; dhe (ii) data e cila bie gjashtë muaj pas një date të tillë pagese; (c) në lidhje me interesin e rrjedhur mbi një shumë të papaguar: (i) data e detyruar e kësaj shume; dhe (ii) data që bie 6 muaj pas kësaj date të detyruar; (d) çdo përvjetor i datave të specifikuara në (a) (i) dhe (ii), (b) (i)

dhe (ii) dhe (c) (i) dhe (ii);
me kusht që nëse çdo datë e tillë nuk është Ditë Pune atëherë Data e Llogaritjes do të jetë Dita e Punës tjetër pasardhëse.

"Periudhë e Llogaritjes" do të thotë çdo periudhë 6 mujore që fillon në një Datë Llogaritjeje dhe përfundon në datën më të parë paraardhëse të Datës së Llogaritjes tjetër në vijim, me përjashtim të Periudhës së Llogaritjes së fundit që do të përfundojë në Datën e Ekzekutimit (në rastin e ndonjë llogaritje sipas Seksionit 7.05) ose datën aktuale të pagesës (ne lidhje me ndonjë llogaritje sipas Seksionit 8.08).

"Vendimet e Këshillit të Ministrave" do të thotë Vendimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 834 datë 30 Dhjetor 1998 dhe Aneksin 1 të bashkëngjitur këtij vendimi (instruksione mbi paraqitjen e ofertave për tender), Nr. 217 datë 23 Prill 1999, Nr. 218 date 23 Prill 1999 dhe Nr. 18 datë 21 Janar 2000.

"Borxh" do të thotë, në lidhje me çdo person, të gjitha detyrimet e këtij personi, qoftë të ndodhura në mënyrë të drejtperdrejtë ose si garantues dhe qoftë të tashme, të ardhme, aktuale ose të mundshme, për pagimin ose shlyerjen e parave, duke përfshirë, pa kufizim:
(a) shuma të pagueshme nga ky person në bazë të qirave ose marrëveshjeve të ngjashme gjatë periudhave të tyre përkatese;
(b) çdo kredi dhënë këtij personi nga një furnizues mallrash ose në bazë të çdo blerje me këste apo marrëveshje tjetër të ngjashme; dhe
(c) përgjegjesi dhe detyrime të palëve të treta në masën që janë garantuar nga ky person ose që ky person përndryshe ka marrë përsipër ose është bërë përgjejgjës për pagimin e përgjegjësive ose detyrimeve të tilla ose për sa ato janë siguruar nga çdo Barrë mbi pasuritë që zotëron ky person nëse ky person ka marrë përsipër ose jo ose është bërë përgjegjës ose jo për pagesën e përgjegjësive dhe detyrimeve të tilla.

"Drejtor" do të thotë një anëtar të Këshillit Drejtues.

"Pagesa Dividendësh" do të thotë shumën e të gjithë dividendeve paguar për Aksionet e Rishitjes nga Data e Transferimit deri në Datën e Ekzekutimit.

"Dollarë dhe US$" do të thotë monedha ligjore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

"Njoftim i Ngjarjes" do të thotë një njoftim të nënshkruar nga të gjithë Blerësit dhe dërguar Shitesit në përputhje me Seksionin 7.01 që përcakton në detaje të arsyeshme rrethanat e Ngjarjes së Rishitjes që ka ndodhur.

"Aksionet Ekzistuese" është përkufizuar në Recitalin B.

"Borxh Financiar" do të thotë, në lidhje me çdo person, të gjitha Borxhet e këtij personi:
(a) për ose në lidhje me para të marra hua ose që rezultojne nga ndonjë lehtesi kredituese apo marrëveshje financiare;
(b) per çmimin e shtyre të blerjes së aktiveve ose shërbimeve (pervec kerkesave për tu paguar që rezultojne gjate funksionimit të normal të aktivitetit);
(c) që rezultojne në baze të çdo qiraje e cila do të kapitalizohej në bilancin e qiramarresit në përputhje me Parimet Përgjithsisht të Pranuara të Kontabilitetit ose që përndryshe në substancë është një

qira financiare;

(d) që rezultojne në lidhje me çdo obligacion, bono, note, kredi ose letrave me vlerë të tjera, çdo pranim ose kredi dokumentare ose çdo kerkese për t'u arkëtuar të shitur ose të skontuar pervec asaj mbi baza të pakthyeshme; ose

(e) që rezultojne në baze të ndonje transaksioni tjetër i cili, në përputhje në Parimet Pergjithsisht të Pranuara të Kontabilitetit, ka efektin komercial të huamarrjes.

"Llogaritë Financiare" do të thotë, llogaritë financiare (përfshirë bilancin, llogarinë e të ardhurave dhe pasqyrën e hyrjeve monetare, dhe shënimet në to) të Shoqërisë përgatitur në përputhje me Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit.

"Viti Financiar" do të thotë, periudha që fillon çdo vit me 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetorin në vijim.

"Transhi i Parë i Kredisë" do të thotë, një transh aktivesh, pasivesh dhe zërash jashte bilancit të Shoqërisë, vlera neto e të cilave, e bashkuar me pjesëmarrjet që do të transferohen nga Shoqëria në përputhje me Seksionin 4.02 (e) është rënë dakort nga palët të jete 3.5 miliarde Lek, për t'u transferuar nga Shoqëria tek një Ent Shtetëror (apo ent tjetër i sugjeruar nga Shitësi dhe i pranueshëm për Blerësit).

"Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit" do të thotë, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të shpallura nga Komiteti i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të zbatuara në mënyrë konsistente.

"Interesi Ndërbankar" do të thotë, për çdo Periudhë Llogaritjeje, interesin vjetor të ofruar për depozita në Dollarë që paraqitet në Faqet e Referencës në ora 11:00 para dite, ora e Londrës, në ditën që bie dy Ditë Pune para ditës së parë të një Periudhe Llogaritjeje të tillë, për periudhën që afrohet me tepër me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Llogaritjeje (ose, nëse dy periudha janë të njësoj të përafërta me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Llogaritjeje, mesatarja e dy përqindjeve të interesit përkatese); me kusht që:

a) nese, për çdo arsye, Interesi Nderbankar nuk mund të percaktohet në një kohe të tillë duke iu referuar Faqeve të References, Interesi Nderbankar për një Periudhë Llogaritjeje të tillë do të jete interesi vjetor që është mesatarja aritmetike (e rrumbullakosur nga siper, nëse është e nevojshme në me te aferten e të 1/16 të një për qind) të interesave vjetore të ofruar për depozitat në Dollare për një shumë të krahasueshme me pjesen së ciles i ka kaluar afati për një periudhë të njejte me këtë Periudhë Llogaritjeje që i keshillohen blerësve nga tre banka kryesore aktive në tregun nderbankar në Londer të zgjedhura nga Blerësit; dhe

b) nese ndonjë Pale percakton që depozitat në Dollare në tregun nderbankar në Londer nuk ofrohen në shuma dhe për periudha të tilla, Interesi Nderbankar për një Periudhë Llogaritjeje të tillë do të jetë kostoja e paguesit për shumën së ciles i ka kaluar afati (e shprehur si interes vjetor) për financimin e pjesës së cilës i ka kaluar afati dhe që është gjendje gjate kësaj Periudhe Llogaritjeje nga çfaredo burim që ai zgjedh.

"Tokat dhe ndërtesat" do të thotë tokat dhe ndërtesat të specifikuara në Letrën e

Informimit.

"Lek" do të thotë monedha ligjore e Republikës së Shqipërisë .

"Barrë" do të thotë, çdo hipotekë, peng, detyrim, privilegj, prioritet, hipotekim pa kalim titulli pronësie, kufizim, cedim, barrë, sekuestro, kompensim ose tjetër interes sigurie të çdo lloji ose çdo marrëveshje tjetër ose rregullim që ka si pasojë dhënien e sigurimit mbi ose në lidhje me, ndonje aktiv të tashëm apo të ardhshëm, të ardhura ose të drejta, përfshirë, pa kufizuar, çdo përcaktim të përfituesve apo të marrësve të pagesave që vijnë nga humbja ose çdo rregullimi të ngjashëm nën një policë sigurimi.

"Kontestim" do të thotë çdo kontestim:
(a) të paraqitur në Letrën e Informimit; ose
(b) që rezultojnë nga çdo rrethanë ose shkaktar veprimi që lind para Datës së Transferimit, nëse një rrethanë apo shkaktar i tillë veprimi ka qenë i njohur apo jo nga Shitësi ose Shoqëria ne Datën e Transferimit.

"Ministri i Financave" do të thotë Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë .

"Ministria e Financave" do të thotë Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë .

"Parlamenti" do të thotë parlamenti i Republikës së Shqipërisë .

"Palë" do të thotë një palë në këtë Marrëveshje.

"Ligjet e Privatizimit" do të thotë Ligjet e Republikës së Shqipërisë Nr. 8103 date 28 Mars 1998 dhe Nr. 8433 date 21 Dhjetor 1998.

"Projekt" do të thotë:
(a) ridenominimi i kapitalit aksionar të Shoqërisë në Dollarë;
(b) riorganizimi i kapitalit aksionar të Shoqërisë në mënyrë që Shoqëria të këtë një kapital aksionar të barabartë me shumën prej 10,000,000 US$ dhe ekuivalentin në US$ në datën e ridenominimit të 2,700,000,000 Lekë rrumbullakosur në me të afërten e 10 US$ dhe të ndarë në Aksione të autorizuara të zakonshme me një vlerë nominale prej 10 US$ secila, prej të cilave 1,000,000 janë autorizuar por nuk janë emetuar dhe pjesa tjetër janë emetuar, paguar plotësisht dhe në pronësi të plotë të Ministrisë së Financave në emër të Republikës se Shqipërisë;
(c) transferimi i aksioneve të zotëruara nga Shoqëria në Banken Italo-Shqiptare dhe në Banken Arabo-Shqiptare Islamike një Enti Shtetëror (apo një enti tjetër të sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshem për Blerësit), dhe vlera e pjesëmarrjeve të tilla kur bashkohet me Transhin e Pare të Kredisë të rënë dakort nga Palët të jete 3,5 miliard Lek;
(d) transferimi një Enti Shteteror (apo një enti tjetër të sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshëm për Blerësit) i Transhit të Parë të Kredisë, vlera e të cilit kur mblidhet me pjesëmarrjet referuar në pikën (c) me lart është rënë dakort nga Palët të jete 3,5 miliard Lek;
(e) transferimi në Shoqërinë nga Ministria e Financave, në lidhje me kalimin dhe transferimin e referuar në paragrafet (c) dhe (d) me lart, të Bonove të Thesarit, vlera e të cilave është rënë dakord nga Palët

të jetë 3,5 miliard Lek dhe është subjekt i rregullimeve të mëvonshme në përputhje me paragrafin (i) me poshtë;
(f) privatizimi i Shoqërisë në bazë të Ligjeve të Privatizimit nëpermjet transferimit të 100% të kapitalit aksionar të autorizuar dhe emetuar te Shoqerise (organizuar në përputhje me paragrafin (b) me lart) për tu mbajtur nga Blerësit në proporcionet: BERZH (20% minus një Aksion), KFN (20% minus një Aksion) dhe KB (60% plus dy Aksione);
(g) nënshkrimi nga Blerësit për t'u paguar plotësisht të 1,000,000 Aksioneve të zakonshme të autorizuara dhe të paemetuara të Shoqërisë në proporcionet: BERZH (20%), KFN (20%) dhe KB (60%);
(h) transferimi një Enti Shtetëror (apo një enti tjetër të sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshëm për Blerësit) të Transhit të Dyte të Kredise;
(i) rregullimi ndërmjet Palëve në lidhje me vlerën përfundimtare të rënë dakort të Bonove të Thesarit per t'iu transferuar Shoqërisë sipas paragrafit (e) me sipër në mënyrë që të arrihet një Vlerë Kontabël e Përshtatur zero;
(j) operimi i Shoqërisë si një bankë e licensuar pas Datës së Transferimit në përputhje me Statutin, Licencën Bankare, dhe Dokumentin e Politikës Operuese dhe në mbështetje të Dokumenteve Ndihmëse; dhe
(k) zvogëlimi i kapitalit aksionar të Shoqërisë në 10 milion US$.

"Blerësit" do të thotë KB, BERZH, dhe KFN ose përfaqësuesit e tyre përkates të lejuar.

"Ngjarje Rishitjeje" do të thotë ndonjë ngjarje e përshkruar në Seksionin 7.03.

"Limit Rishitjeje" do të thotë dy për qind (2%) në vit i llogaritur mbi bazë 6 mujore.

"Njoftim Rishitjeje" do të thotë një njoftim i firmosur nga të gjithë Blerësit dhe dërguar Shitesit në zbatim të Seksionit 7.01 që percakton:
(a) numrin total të Aksioneve të Rishitjes të mbajtura nga çdo Blerës në datën e dergimit të një njoftimi të tillë;
(b) shumën e vlerësuar të Çmimit të Rishitjes në lidhje me këto Aksione të Rishitjes (duke përfshirë detajet e llogaritjes), shumë e cila do të përshtatet në Datën e Ekzekutimit në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje;
(c) Datën e Ekzekutimit; dhe
(d) Vendin e Ekzekutimit.

"Periudhë Rishitjeje" do të thotë çdo kohë nga Data e Transferimit deri në përvjetorin e dhjetë të Datës së Transferimit.

"Çmim Rishitjeje" do te thotë çmimi i përcaktuar në Njoftimin e Rishitjes dhe i llogaritur në përputhje me Seksionin 7.05.

"Përqindje Rishitjeje" do të thotë shuma e Interesit Ndërbankar plus Limitin e Rishitjes.

"Aksionet e Rishitjes" do të thotë të gjitha Aksionet që ekzistojnë në datën e dërgimit te një Njoftimi Rishitjeje ne përputhje me Seksionin 7.01, qe jane 100% e kapitalit aksionar të autorizuar të Shoqërise ne këte datë.

"Faqe Reference" do të thotë paraqitja e interesave ndërbankare të ofruara në Londer të bankave kryesore për depozita në Dollare e përcaktuar si faqja 3750 në Shërbimin Telerate të Dow Jones (ose një faqe tjetër e tillë që mund të zëvendësoje faqen 3750 në Shërbimin Telerate të Dow Jones me qëllimin e paraqitjes së interesave bankare të ofruara në Londër për depozitat në Dollarë).

"Aksionet e Shitjes" jane përcaktuar në Recitalin D.

"Transhi i Dytë i Kredisë" do të thotë një transh aktivesh, pasivesh dhe zërash jashtë bilancit të Shoqërisë, për t'iu transferuar një Enti Shtetëror (apo enti tjetër të sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshëm për Blerësit) prej Shoqërisë.

"Datë e Ekzekutimit" do të thotë data e specifikuar në Njoftimin e Rishitjes si data për pagimin e Çmimit të Rishitjes dhe transferimin e Aksioneve të Rishitjes, që do të jetë një Ditë Pune jo me tepër se 45 ditë pas dërgimit të Njoftimit të Rishitjes me kusht që, në qoftë se ndonjë çështje në lidhje me ndodhjen e një Ngjarje Rishitjeje ose llogaritjen e Çmimit të Rishitjes paraqitet në arbitrazh ose në gjykatë në përputhje me Seksionin 8.12 dhe procedime të tilla fillojnë në ose para 40 ditësh nga dërgimi i Njoftimit të Rishitjes, atëherë, Data e Ekzekutimit do të konsiderohet të jetë më e hershmja e datës në të cilën:

(a) procedime të tilla janë zgjidhur;

(b) procedime të tilla janë tërhequr ose lënë; ose

(c) nga ndonjë arbitrim ose gjykatë është marrë një vendim përfundimtar në lidhje me procedime te tilla.

Për shmangien e dyshimit, në qoftë se ndonjë procedim i tillë ka filluar pas më tepër se 40 ditëve nga dërgimi i Njoftimit të Rishitjes, Data e Ekzekutimit do të mbetet ajo që është përcaktuar në Njoftimin e Rishitjes.

"Vend i Ekzekutimit" do të thotë vendi i specifikuar në Njoftimin e Rishitjes përkatës për Republikën e Shqipërisë për të paguar dhe Blerësit për t'i transferuar Republikës së Shqipërisë Aksionet e Rishitjes të shitura atëherë (përfshirë llogarinë në të cilën do të paguhet Çmimi i Rishitjes).

"Aksion" do të thotë çdo Aksion Ekzistues, Aksion Shitjeje, Aksion Rishitjeje, dhe çdo aksion tjetër Shoqërisë së bashku me të drejtat për të poseduar çdo aksion të tillë, dhe do të përfshijë çdo aksion të tillë ose të drejtë të dhënë mbi konvertimin, nënndarjen ose konsolidimin e çdo aksioni të tillë ose me ushtrimin e një të drejtë të tillë.

"Qendra e Regjistrimit të Aksioneve" do të thotë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve e ngritur në bazë të Ligjit të Republikës së Shqipërisë Nr. 8108 datë 28 Mars 1996 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 112 datë 19 Shkurt 1996.

"Ent Shteteror" do të thotë çdonjëri prej:

(a) vete Republika e Shqipërisë ;

(b) Banka e Shqipërisë

(c) çdo organ legjislativ, çdo autoritet rregullator për tregtimin e letrave me vlerë, ministri ose departament, çdo autoritet gjyqësor civil apo ushtarak i çdo natyre qoftë (duke përfshirë çdo gjykatë) në çdo rast të Republikës së Shqipërisë ose çdo nënndarje politike ose

administrative të Republikës së Shqipërisë ; dhe

(d) çdo pushtet lokal, koorporate, organizate publike ose njësi tjetër që zotërohen ose kontrollohen direkt apo indirekt, ose që punojnë për llogari ose interes të një ose më shumë agjensive të Republikës së Shqipërisë .

"Nënshkrim" do të thotë nënshkrimi sipas Projektit nga Blerësit (me pagesë të plotë) të 1,000,000 Aksioneve të zakonshme të autorizuara dhe të paemetuara në proporcionet: BERZH (20%), KFN (20%) dhe KB (60%).

"Aksionet e Nënshkrimit" do të thotë Aksionet e blera nga Blerësit sipas Nënshkrimit.

"Filial" do të thotë, në lidhje me çdo njësi, çdo njësi tjetër që mbi 50% e kapitalit të saj aksionar zotërohet, direkt ose indirekt, nga kjo njësi ose e cila përndryshe efektivisht kontrollohet nga një njësi e tillë.

"Transferim" do të thotë transferimi dhe shitja e Aksioneve të Shitjes nga Shitësi tek Blerësit në përputhje me Seksionin 3.01.

"Datë e Transferimit" do të thotë data në të cilën ndodh Transferimi.

"Bono Thesari" do të thotë një instrument borxhi në një forme të rënë dakord, emetuar nga Ministri i Financave me maturim 6 muaj ose një periudhë tjetër maturimi siç do të bihet dakord midis Palëve.

Seksioni 1.02. Interpretimi

(a) Në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që përcaktojnë njejësin përfshijnë dhe shumësin dhe anasjelltas; dhe

(b) Ne këtë Marrëveshje, përveç kur shfaqet qëllimi i kundërt, një reference në :

(i) "aktive" përfshin pasuritë, të ardhurat dhe të drejtat e çdo përshkrimi;

(ii) "kontroll" (duke përfshirë, me kuptime të ndërlidhura me të, termat "kontrolluar nga" dhe "nën kontroll të përbashkët me") përdorur në lidhje me ndonjë person, nënkupton posedimin, direkt apo indirekt, të së drejtës për të drejtuar ose shkaktuar drejtimin e manaxhimit dhe politikat e një personi të tillë, si nëpermjet zotërimit të aksioneve votuese, interesit të pronësisë, kontratës apo në forme tjetër;

(iii) nje "muaj" është një referencë për një periudhë që fillon nga një ditë në një muaj kalendarik dhe përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në ditën në muajin tjetër kalendarik, me përjashtim kur, nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në muajin në të cilin përfundon kjo periudhë, ajo periudhë do të përfundojë në ditën e fundit të atij muaji kalendarik;

(iv) nje "person" do të përfshijë çdo individ, person juridik, firmë, Shoqëri, partneritet, Ent Shteteror, joint-venture, së bashku me pasuesit, të ngarkuarit e lejuar ose të transferuarit e lejuar të një personi të tillë;

(v) "rregullore" përfshin çdo udhëzim të çdo Enti Shtetëror;

(vi) kjo Marrëveshje ose çdo dokument tjetër, kontrate ose marrëveshje do të përfshije një reference për çdo ndryshim të lejuar ose shtojce të kësaj marrëveshje dhe çdo dokument, kontrate ose marrëveshje të tillë sic mund të ndryshohet, varioje ose shtohet kohe pas kohe por duke mos marre parasysh ndonjë ndryshim, shtese, zevendesim apo rinovim të bere ne shkelje te kësaj Marrëveshje;

(vii) kjo Marrëveshje i referohet kësaj Marrëveshje së bashku me Recitalet dhe Pasqyrat bashkëngjitur kësaj Marreveshje;

(viii) çdo ligj, statut, dekret ose dispozitë ligjore do të përfshijë (përveç kur të vendoset nëse ka ndodhur një Ndryshim në Ligj) çdo ligj, statut, dekret ose dispozitë ligjore që ndryshon ose zevëndëson ose ka ndryshuar ose zevëndesuar ato dhe, do të përfshijë çdo legjislacion të nënrenditur (duke përfshirë, por pa kufizuar, çdo udhezim ose vendim të një Enti Shteteror) të hartuara në bazë të

një ligji, statuti, dekreti ose dispozitë ligjore të tillë;

(ix) nje Recital, Nen, Seksion ose, Pasqyrë, do të kuptohen si referencë ndaj atij Recitali, Neni, Seksioni, ose Pasqyrë të specifikuar, bashkëgjitur kësaj Marrëveshjeje;

(x) titujt dhe tabela e përmbajtjes janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk influencojnë interpretimin e kësaj Marreveshje; dhe

(xi) nje dokument "ne formën e rënë dakord" do të nënkuptojë formën e një dokumenti të tillë të sigluar më parë nga Palët.

Neni II

Deklarimet dhe Garancitë

Seksioni 2.01. Deklarimet në lidhje me Privatizimin

Shitësi deklaron dhe garanton secilin nga Blerësit si vijon:

(a) Privatizimi i Shoqërisë është kryer dhe do të kryhet në përputhje me Ligjet e Privatizimit dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave.

(b) Zgjedhja nga Shitësi e KB si investitor strategjik në Shoqëri u krye në bazë të një procesi të drejtë dhe transparent, në përputhje me Ligjet e Privatizimit dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe nuk ka pasur shkelje të Ligjeve të Privatizimit, Vendimeve të Këshillit të Ministrave ose Ligjeve të Aplikueshme; dhe

(c) me dorëzimin fizik nga Shitësi tek Shoqëria, transferimi i Bonove të Thesarit do të këtë përfunduar dhe Shoqëria do të fitojë titull të plotë pronësie ndaj këtyre Bonove të Thesarit në përputhje me Ligjet e Aplikueshme.

Seksioni 2.02.Deklarimet në lidhje me Shoqërinë

Shitësi deklaron dhe garanton secilin nga Blerësit si vijon:

(a) Shoqëria është një shoqëri anonime, e organizuar sipas rregullave dhe që ekziston vlefshmërisht në bazë të Ligjeve të Aplikueshme, e regjistruar në të gjithe organet përkatese të regjistrimit në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria gëzon të drejta të plota për të përdorur dhe zotëruar pronat (përfshirë Tokën dhe Ndërtesat) që përdor ose zotëron dhe ka fuqi të plotë për të kryer aktivitetin që ushtron dhe Projektin.

(b) në datën e kësaj Marrëveshje, Shoqëria ka një kapital aksionar të autorizuar prej 2,700,000,000 Lekë të ndarë në 27,000 Aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 100,000 Lek secila;

(c) Shitësi ka titull të plotë pronësie mbi të gjithë Aksionet Ekzistuese. Të gjitha Aksionet Ekzistuese janë emetuar në menyrë të vlefshme, në qarkullim dhe paguar plotësisht dhe përbëjnë teresine e kapitalit të emetuar, nënshkruar dhe paguar plotësisht të Shoqërisë. Nuk ekzistojne opsione, mundesi blerjeje të aksioneve nga të trete ose instrumenta të konvertueshem në Aksione ose marrëveshje të tjera lidhur me Aksionet Ekzistuese ose për emetimin e Aksioneve shtese të çdo klase ose pershkrimi. Asnje person nuk ka ndonjë të drejtë (pervecse të asaj prej aksioneri) të marre pjesë në fitimet e Shoqërisë. Nuk ekzistojnë letra me vlerë të tjera të Shoqërisë direkt apo indirekt të konvertueshme në ose të shkembyeshme për Aksione;

(d) Aksionet e Shitjes, kur t'i lëvrohen Blerësve, do të jenë të autorizuara sipas rregullave, të emetuara vlefshmerisht, të paguara plotësisht dhe të lira e të pastra nga të gjitha Barrët dhe pretendimet.

(e) nuk ekzistojnë mundësi blerjeje aksionesh nga të tretë, opsione ose të drejta të tjera të parealizuara për të blerë apo fituar, ose (pervec të drejtave të para blerjes të përcaktuara në Statut) të drejta parablerje në lidhje me emetimin apo shitjen e Aksioneve.

(f) Licenca Bankare është dhënë në mënyrë të vlefshme dhe mbahet nga Shoqëria dhe e lejon Shoqërinë të kryeje aktivitet bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin Bankar.

(g) Shoqëria nuk ka Filiale. Përvec siç është detajuar në Letrën e Informimit të Shoqërisë, Shoqëria nuk zotëron ndonjë letër me vlerë të emetuar nga ndonjë ent ligjor tjetër ose Ent Shteteror. Shoqëria nuk është partnere ose pjesëmarrëse në ndonjë joint – venture, ose partneritet të çfaredo lloji.

(h) deri në datën e kësaj Marrëveshje, informacioni i përmbajtur në Letrën e Informimit të

Shoqërisë është i vrëtetë, i plotë dhe korrekt në të gjithë aspektet materiale dhe Letra e Informimit e Shoqërisë nuk përmban deklarata të pavërteta ose të shtrembëruara dhe nuk le pa pasqyruar ndonjë fakt material që mund t'i bënte deklaratat të paverteta ose të shtrembëruara. Në masën që ndonjë informacion që përmbahet në Letrën e Informimit të Shoqërisë lidhet me parashikime ose projektime të ngjarjeve të ardhshme, këto parashikime dhe projektime janë përgatitur në mirëbesim, duke dhënë konsiderata të drejta dhe të kujdesshme për të gjithe faktorët përkatës dhe bazuar në supozime që ishin të arsyeshme në kohën që këto parashikime dhe projektime u përgatiten, dhe që nga data që parashikime dhe projektime të tilla u përgatiten nuk ka ndodhur asgjë që mund ti bëjë ato të paarsyeshme;

(i) Llogaritë Financiare të Shoqërisë deri me 31 Dhjetor 1999 për Vitin Financiar që mbaron në këtë datë, të vërtetuara nga Auditorët, paraqesin një pamje të vërtetë dhe korrekte të gjendjes financiare të shoqërisë që nga data e këtyre Llogarive Financiare dhe u përgatiten në përputhje me Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit. Përveç sa deklarohet të këto Llogari Financiare, Shoqëria, deri në datën e këtyre Llogarive Financiare, nuk ka detyrime materiale të mundshme, detyrime për taksa ose zhvillim të pazakonshëm ose angazhime afatgjata të pa zbuluara nga, ose rezervuara në këto Llogari Financiare. Që nga data e këtyre Llogarive Financiare Shoqëria nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të kundërt material në aktivitetin e saj, operimet apo gjendjen financiare, nuk ka pesuar ndonjë humbje thelbësore apo të pazakonshme ose detyrim ose ka marrë përsipër apo ka rënë dakort për të marrë përsipër ndonjë detyrim thelbesor ose të pazakonshëm perveç atyre sipas Dokumentave Ndihmëse.

(j) Llogaritë Financiare dorëzuar në përputhje me Seksionin 6.02(a), të vërtetuara nga Auditorët, do te paraqesin një pamje të vërtetë dhe korrekte të gjendjes financiare të Shoqërisë deri në datën e këtyre Llogarive Financiare dhe do të jenë përgatitur në përputhje me Parimet Përgjithesisht të Pranuara të Kontabilitetit. Perveç sa deklarohet të këto Llogari Financiare, Shoqëria që nga data të ketyre Llogarive Financiare, nuk do te kete detyrime materiale të mundshme, detyrime për taksa ose zhvillim të pazakonshem ose angazhime afat-gjata të pazbuluara nga, ose rezervuara ndaj, në këto Llogari Financiare. Që nga data e këtyre Llogarive Financiare e deri në Transferim, Shoqëria nuk do të pësoje ndonjë ndryshim material të kundert në aktivitetin e saj, operimin ose gjendjen financiare, nuk do të pësoje ndonjë humbje thelbësore apo të pazakonshme ose detyrim ose të marrë persiper apo të këtë rënë dakort për të marrë përsiper ndonjë detyrim thelbesor ose të pazakonshem përveç atyre sipas Dokumentëve Ndihmese.

(k) Shoqëria ka titull të plotë dhe të qartë pronësie mbi Tokën dhe Ndërtesat. Asnje person tjetër nuk ka ngritur pretendim pronësie ose ndonjë interes tjetër ndaj titullit të pronesisë për Tokën dhe Ndërtesat pervec rasteve të permendura në Letrën e Informimit të Shoqërisë. Përveç sa është deklaruar në Letrën e Informimit të Shoqërisë, asnjë person tjetër nuk ka ngritur pretendimin ndaj ndonjë të drejte të përdorimit ose ndonjë të drejte të ngjashme për Tokën dhe Ndërtesat. Toka dhe Ndërtesat janë në zotërim të pacenuar të Shoqërisë. Toka dhe Ndërtesat janë zene dhe perdoren vetem nga Shoqëria . Pervec sa është deklaruar në Letrën e Informimit të Shoqërisë, aktivet e Shoqërisë janë të lira nga çdo kufizim ose angazhim që mund të kete një efekt të kundert material mbi Projektin. Pervec sa është deklaruar në Letrën e Informimit të Shoqërisë, aktivet e Shoqërisë nuk janë subjekt i ndonjë Barre, dhe Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë kontrate, rregullimi apo ligji, i kushtëzuar ose i pakushtzëuar, në bazë të së cilit mund të krijohet ndonjë Barrë mbi pasuritë e saj.

(l) Përvec sa është deklaruar në Letrën e Informimit të Shoqërisë, Shoqëria nuk është pale në, ose ka marrë angazhim për të hyrë në ndonjë marrëveshje tjetër pervec Dokumentave Ndihmese në të cilat është një pale që:

(i) përfshin pagesën e me shumë së US$ 25,000 (ose ekuivalentit të tyre në monedha të tjera) në vit ose në total me shumë se 100,000 Dollare (ose ekuivalentit të tyre në monedha të tjera) brenda afatit prej tre vjetesh;

(ii) ka të bëjë me Projektin; ose

(iii) do të ndikonte materialisht gjykimin e një investitori të mundshëm që vepron në mënyrë të arsyeshme rreth vendimit për të hyrë në këtë Marrëveshje ose Dokumentet Ndihmëse dhe për të investuar në Shoqëri.

(m) Drejtorët janë Spiro Brumbulli, Asllan Shera, Bashkim Ruseti, Artan Koxhuku, Ermira Basha dhe Elsa Bizhga. Drejtorët e Përbashkët të Përgjithshëm të Shoqërisë janë Spiro Brumbulli dhe Seyhan Pencapligil. Drejtor i Thesarit është Ilirjan Ligacaj. Drejtor i Kreditit është Irena Isufi. Drejtor

i Pagesave është Lindita Palikuqi. Drejtor i Kontabilitetit është Albert Barci. Secili prej ketyre zyrtarëve te referuar në këtë Seksion 2.02 (m), është emëruar sipas rregullave dhe aktualisht vepron në përputhje me Ligjet e Aplikueshme;

(n) Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë ligji aktualisht në fuqi. As Shoqëria dhe as Shitësi nuk ka dijeni që është propozuar apo pritet të propozohet ndonjë ligj i cili mund të kishte ndikim material të kundërt mbi aktivitetin e Shoqërisë, Projektin, operimin apo gjendjen financiare të Shoqërisë ose aftësinë e Shoqërisë për të përmbushur çdo detyrim të saj sipas çdo marrëveshje ku ajo është palë. Të gjitha të ardhurat e tatueshme dhe raportet e taksave të Shoqërisë të kërkuara për t'u plotësuar nga Ligjet e Aplikueshme janë plotësuar rregullisht dhe të gjitha vlerësimet e taksave, komisioneve dhe detyrimeve të tjera qeveritare ndaj Shoqërisë, aktiveve dhe të ardhurave të saj të cilat janë kohën për t'u paguar dhe të pagueshme, janë paguar përvec atyre të pagueshme në vazhdim pa penalitete dhe interesa. As Shitësi dhe as Shoqëria ose ndonjë prej zyrtareve perkates, drejtoreve ose punonjesve të autorizuar, agjenteve ose perfaqësuesve nuk ka:

(i) paguar ose marrë, premtuar ose ofruar për të paguar, ose autorizuar pagesën, ndonjë komisioni, rryshfeti, mite, ose gjobe lidhur me Projektin, që dhunon ndonjë prej Ligjeve të Aplikueshme ose hyrë në ndonjë marrëveshje në bazë të së ciles ndonje komision, rryshfet, mite, ose gjobe e tillë mund ose do të paguhet në çdo kohe; ose

(ii) ofruar ose dhënë çdo gjë me vlerë për të influencuar veprimin e një zyrtari publik, ose kërcenuar dëmtimin e një personi, pronesie apo reputacioni, në lidhje me Projektin me qëllim që të siguroje ose perfitoje aktivitete apo avantazhe jo të drejta lidhur me kryerjen e aktivitetit;

(o) Shoqëria nuk është në mospermbushje të ndonjë Marrëveshjeje, detyrimi apo detyre në të cilën është palë ose në bazë të së ciles ajo ose ndonje prej pronave apo aktiveve te saj është e lidhur dhe nuk egziston ndonjë rast mospermbushjeje ose, me sa eshte ne dijeni ajo, ndonje rast i mundshëm mospermbushjeje sipas një marrëveshjeje të tillë. As Shoqëria as ndonjë prej zyrtareve të saj, ose për sa di ajo ndonjë prej agjenteve ose punonjësve të saj, (gjate ushtrimit të detyrave të tyre), nuk kane bere ose lene pa bere asgje që është në kundërshtim me Ligjet e Aplikueshme që jep shkak për ndonjë gjobe ose penalitet ose përgjegjësi për penalitet nga ana e Shoqërisë që tejkalon ekuivalentin e US$ 10,000;

(p) Shoqëria dhe aktivitetet e saja, operimi, aktivet, paisjet, pasuritë, qirambajtjet, Toka dhe Ndërtesat dhe mjetet e tjera janë në përputhje me dispozitat e aplikueshme të legjislacionit të mjedisit, shëndetit, dhe sigurisë. Shoqërisë i janë dhënë të gjitha Autorizimet e duhura lidhur me, dhe nuk ka marrë asnjë ankesë, urdhër, direktive, pretendim, citim ose shkresë nga ndonjë Ent Shtetëror ose person tjetër lidhur me nxjerjen e ajrit, shkarkimin në ujrat sipërfaqësore ose ujrat tokësore, zhurmat, depozitimin e mbetjeve likuide apo të ngurta, përdorimin, përftimin, magazinimin, transportimin ose hedhjen e substancave toksike ose substancave të rezikshme apo mbetjeve ose cështje të tjera mjedisore, shëndetesore ose të sigurisë. Nuk ekziston ndonjë ndotje në vendodhjen e ndonjë prej Tokave apo Ndërtesave. Përveç sa permendet në Letrën e Informimit të Shoqërisë, as Shoqëria as Shitësi nuk di asnjeë argument që mund të bëhet shkak për ngritjen e ndonjë konflikti, arbitrimi ose procedure administrative kunder Shoqërisë.

(q) pervec çeshtjeve të detajuara në Letren e Informimit të Shoqërisë, Shoqëria nuk është e përfshirë në, ose ne dijeni te ndonje kercenimi nga ndonjë konflikt, arbitrim ose procedure administrative, rezultati i të cilave mund të sjelle efekt të kundert material në Projekt, në aktivitetin e Shoqërisë, operimin ose gjendjen financiare apo aftesine e Shoqërisë për të permbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas çdo Marrëveshjeje në të cilën është pale.

(r) të gjitha informacionet e nevojshme, njoftimet, llogaritë, deklaratat, raportet, llogaritjet dhe të ardhurat që duhet të jene bëre ose dhënë, janë paraqitur rregullisht dhe në mënyre të përshtatshme nga Shoqëria tek autoritetet kompetente tatimore, si të Republikës së Shqipërisë apo dhe kudo, dhe të gjitha informacionet, njoftimet, llogaritjet dhe të ardhurat e paraqitura janë të verteta dhe të sakta dhe nuk janë subjekt i ndonjë mosmarrëveshjeje materiale dhe as nuk janë të mundshme për t'u bërë subjekt i ndonjë mosmarrëveshjeje materiale me këto autoritete.

(s) të gjitha tatimet e çfarëdolloj natyre, si të Republikës së Shqipërisë apo dhe kujdo për të cilat Shoqëria është përgjegjëse, janë paguar rregullisht (për aq sa ky tatim duhet të ishte paguar) dhe pa paragjykime në përgjithshmërinë e sa me sipër Shoqëria ka bere zbritjet dhe mbajtjet siç ka qënë e detyruar dhe e autorizuar për të bërë dhe siç duheshin bëre të gjitha këto pagesa;

(t) Shoqëria është në pajtim me të gjitha Ligjet e Aplikueshme dhe praktikat në lidhje me

punësimin, kushtet dhe afatet e punësimit, duke përfshirë por pa kufizuar, dispozitat në lidhje me pagat, shpërblimet, oret e punës dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, kujdesin mjekësor dhe sigurimin për jetën; dhe

(u) transferimi i Transhit të Parë të Kredisë dhe pjesëmarrjet e Shoqërisë në Bankën Italo Shqiptare dhe Banken Arabo-Shqiptare Islamike në përputhje me këtë Marrëveshje, do të kryhet në përputhje me Ligjet e Aplikueshme.

Seksioni 2.03. Deklarimet në lidhje me këtë Marrëveshje

Shitesi deklaron dhe garanton secilin nga Blerësit si vijon:

(a) Ministri i Financave (ne emër të Republikës së Shqipërisë) ka fuqine dhe autoritetin për të hyre në dhe permbushur këtë Marrëveshje;

(b) me miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti dhe publikimit të ligjit përkates që miraton këtë Marrëveshje ne Fletorja Zytrare, kjo marrëveshje do të autorizohet dhe ekzekutohet sipas rregullave nga Shitësi dhe do të perbeje detyrim ligjor të vlefshem për Shitesin, të zbatueshem në përputhje me kushtet e saj. Berja e kësaj marrëveshje dhe pajtimi me kushtet e saj nuk do te:

(i) rezultojë në shkeljen e ndonjë dispozite që permbahet në ndonjë ligj të zbatueshem ndaj Shitesit ose Shoqërisë ose në ndonjë traktat nderkombetar të aplikueshem ndaj Shitesit;

(ii) jetë në konflikt me ose rezultojë në shkelje të ndonjë dispozite te, ose kerkoje ndonjë miratim sipas, ose rezultoje në imponimin e ndonjë Barre sipas, ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti në të cilin Shitësi ose Shoqëria është pale ose sipas të cilit Shitësi apo Shoqëria ose ndonjë nga aktivet e tyre përkatese janë të lidhur; dhe

(iii) nuk do të përbeje ndonjë mospermbushje ose ngjarje e cila, me dhënien e njoftimit, kalimin e kohës ose berjen e ndonjë percaktimi, ose kombinimi të tyre, do të perbente një mospermbushje të ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti të tillë;

(c) nuk kërkohet asnjë Autorizim për ekzekutimin e duhur, dorëzimin ose përmbushjen nga Shitesi, ose vlefshmerine dhe zbatueshmerine e kësaj Marrëveshje, apo të Dokumentave Ndihmëse perveçse për miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti dhe publikimin e ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje ne Fletoren Zytrare; dhe

(d) nuk ekziston ndonjë pullë ose taksa të tjera ose detyrim i ndonjë Enti Shteteror ose i ndonjë autoriteti tatimor, federate apo shoqate në të cilat Republika e Shqipërisë është anetare, për t'u detyruar mbi, ose rrjedhoje e ekzekutimit, kryerjes ose permbushjes së kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë transaksioni të parashtruar në te, për të siguruar ligjshmerinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose pranueshmërine faktike të kësaj Marrëveshje në Republikën e Shqipërisë .

Seksioni 2.04. Njohja dhe Garancia

Shitësi pranon se deklarimet dhe garancitë që permbahen në Seksionin 2.01, Seksionin 2.02 dhe Seksionin 2.03 janë bere me synimin për inkurajuar sejcilin prej Blerësve për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe se sejcili prej Blerësve ka hyre në këtë Marrëveshje ne bazë te, dhe në mbështetje të plote te çdo deklarimi dhe garancie të tillë. Shitësi garanton që çdo deklarim dhe garanci e tillë është e vertete dhe korrekte dhe që ai nuk ka dijeni për ndonjë fakt ose çeshtje shtese mospermendja e së ciles ben ndonjërin prej ketyre deklarimeve dhe garancive të shtremberuara ose që në menyre të arsyeshme do të ose mund të pritej të influenconte gjykimin e një blerësi të mundshëm në lidhje me blerjen e Aksioneve të Shitjes.

Seksioni 2.05.Kufizimi i përgjegjësisë së Shitësit

(a) Përgjegjësia e Shitësit për shkeljen e ose sipas sejcilit prej deklarimeve dhe përfaqësimeve që permbahen në Seksionin 2.01, Seksionin 2.02 dhe Seksionin 2.03 do të kufizohet si me poshtë:

(i) nuk do të ngrihet asnjë pretendim ndaj Shitesit në lidhje me çdo përgjegjësi te tille nëse Shitesit nuk i është bere njoftim me shkrim për një pretendim të tillë duke specifikuar në detaje të arsyeshme natyren e pretendimit sa me shpejt që të jete praktikisht e mundur pasi Blerësi që ka ngritur një pretendim të tillë të jete në dijeni që rrethanat të cilat shkaktuan këtë pretendim rezultuan në demtim; dhe

(ii) nje Blerës i tillë do t'i rimbursojë menjehere Shitesin, plotësisht pa ndonjë ndalese, kundërpretendim, zbritje ose mbajtje të çdo lloji, një shumë të barabarte me çdo shumë të paguar nga Shitësi ne lidhje me çdo përgjegjësi të tillë që për pasoje rekuperohet nga një Blerës i tillë ose Shoqëria nga ndonjë palë e tretë, me kusht që një rimbursim i tillë të mos përfshijë:

(1) ndonjë ndalese, kunder pretendim, zbritje ose mbajtje të kerkuar sipas ligjit; dhe

(2) kostot e një rekuperimi të tillë që janë shkaktuar nga ndonje Blerës;

(b) nuk do të ngrihet asnje përgjegjësi e Shitesit në lidhje me ndonjë shkelje të ose pretendim në lidhje me garancitë dhe deklarimet që permbahen në Seksionin 2.01, Seksionin 2.02, dhe Seksionin 2.03:

(i) në masën që një shkelje ose pretendim i tillë shkaktohet si rezultat i ndonjë ndryshimi pas Transferimit në bazat dhe politikat e kontabilitetit në përputhje me të cilin Shoqëria i vlerëson aktivet e saj ose i llogarit pasivet ose ndonjë ndryshim tjetër në praktikat e kontabilitetit; dhe

(ii) në masën që një shkelje ose pretendim i tillë shkaktohet si rezultat i ndonjë veprimi ose mosveprimi nga Shoqëria ose Shitësi me kerkesen e Blerësve.

(c) Të vetmet deklarime dhe garanci të dhena nga Shitësi ne lidhje me çfare përmbahet ne kete Marrëveshjeje dhe të Dokumentave Ndihmese janë ato të përcaktuara në Seksionin 2.01, Seksionin 2.02, dhe Seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.06. Deklarimet dhe garancitë e Blerësve

Secili prej Blerësve deklaron dhe i garanton Shitësit si vijon:

(a) ai ka fuqinë dhe autoritetin për të hyrë në dhe përmbushur këtë Marrëveshje;

(b) nuk kërkohet asnje Autorizim për ekzekutimin e duhur, dorëzimin ose permbushjen prej tij të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) kjo Marrëveshje perben detyrim të vlefshem dhe ligjor për një Blerës të tillë të zbatueshme në perputhje me kushtet e afatet e saj dhe berja e kësaj Marrevshjeje dhe përmbushja e kushteve të saj nuk do te:

(i) rezultojë në shkeljen e ndonjë klauzole të permbajtur në ndonjë ligj të aplikueshem ndaj një Blerësi të tillë ose ndonjë traktati nderkombetar të aplikueshem ndaj një Blerësi të tillë;

(ii) jetë në konflikt ose rezultoje në shkeljen e ndonjë klauzole të ose të kerkoje ndonjë miratim sipas, ose të rezultoje në imponimin e ndonjë Barre sipas, ndonjë Marrëveshjeje ose instrumenti ndaj të cilit një Blerës i tillë është pale ose sipas së ciles një Blerës i tillë ose ndonjë prej aktiveve të tij është i lidhur; ose

(iii) përbejë një mospermbushje ose një ngjarje e cila, me dhënien e njoftimit, kalimin e kohës ose berjen e ndonjë vendimi, ose kombinimi të tyre, do të perbente një mospërmbushje sipas çdo marrëveshjeje ose instrumenti të tillë.

Neni III
Shitja e Aksioneve

Seksioni 3.01. Transferimi i Aksioneve të Shitjes

(a) Në varësi të nenit VI, Shitësi do t'i shesë:

(i) BERZH-it dhe BERZH do të blejë nga Shitësi, dhe paguajë plotësisht në përputhje me Seksionin 3.03, 20% pa një Aksion të Shitjes të Aksioneve të Shitjes me të gjitha të drejtat bashkëngjitur ndaj tyre;

(ii) KFN-se dhe KFN do të blejë nga Shitësi, dhe paguajë plotësisht në përputhje me Seksionin 3.03, 20% pa një Aksion të Shitjes të Aksioneve të Shitjes me të gjitha të drejtat bashkëngjitur ndaj tyre; dhe

(iii) KB-se dhe KB do të blejë nga Shitesi, dhe paguajë plotësisht në përputhje me Seksionin 3.03, 60% plus dy Aksione të Shitjes të Aksioneve të Shitjes me të gjitha të drejtat bashkengjitur ndaj tyre.

Me kusht që, në qofte së numri i Aksioneve të Shitjes nuk është i ndashem në përputhje me dispozitat e Seksionit 3.01 (a), Blerësit do të kene të drejtën t'i kerkojne Shitësit që te ndajë Aksionet e Shitjes ndërmjet Blerësve në raportet që do të specifikojnë Blerësit.

(b) Shitësi bie dakort me secilin prej Blerësve si vijon:

(i) që ai ka të drejtë të shesë dhe transferojë titullin e plotë të pronësise së Aksioneve të Shitjes tek një Blerës i tillë në përputhje me këtë Marrëveshje; dhe

(ii) që gjatë ose pas Transferimit, me kostot dhe shpenzimet e tij, do të ekzekutojë dhe beje (ose do të prokuroje ekzekutimin dhe berjen nga një palë tjetër e nevojshme) të gjitha vërtetimet e pronësise, dokumentat, aktet dhe gjera të tilla sic mund ky Blerës të kërkojë kohe pas kohe për t'i kaluar çdonjërin prej Aksioneve të Shitjes këtij Blerësi ose të ngarkuarit të tij, ose sic mund të jete e nevojshme perndryshe për ta bere këtë Marrëveshje plotësisht efektive.

(c) Aksionet e Shitjes do të shiten të lira nga të gjitha Barrët dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga pale të treta.

(d) Asnjë nga Blerësit nuk do të jetë i detyruar të bëjë blerjen e ndonjë prej Aksioneve të Shitjes po të mos jete përfunduar në mënyrë simultane blerja e të gjitha Aksioneve të Shitjes në përputhje me këtë Marrëveshje.

Seksioni 3.02. Çmimi i Blerjes

Kompensimi në total për shitjen e Aksioneve të Shitjes Blerësve do të jetë shuma prej 1 US$ (nje Dollar) i pagueshëm me para në dorë në Transferim.

Seksioni 3.03. Koha dhe Vendi i Transferimit

Në varësi të nenit VI, Transferimi do të bëhet në zyrat qendrore të Shoqërisë në Tiranë në orën 12:00, më 1 Tetor 2000, ose në një tjetër vend, date ose kohe të tillë siç mund të fiksohet me marrëveshje të përbashkët nga Palët.

Seksioni 3.04. Dorëzimi i Aksioneve të Shitjes

(a) Në Transferim, Shitësi do dorëzojë ose do të shkaktojë dorëzimin tek Blerësit:

(i) çertifikatata individuale aksioni që përfaqësojnë Aksionet e Shitjes të shitura tek secili nga Blerësit sipas Seksionit 3.01 dhe që evidenton titullin e vlefshëm të këtyre Aksioneve te Shitjes për Blerësin në fjalë, të nënshkruara sipas rregullit nga Shitësi për transferim;

(ii) nje ekstrakt të vërtetuar të regjistrit të aksionerëve të shoqërisë që reflekton regjistrimin e Aksioneve të Shitjes në emrin e secilit prej Blerësve në përputhje me Seksionin 3.01(a);

(iii) dokumenta të tjere të tillë siç mund të kërkohen për të bërë të efektshem një transferim të vlefshëm të Aksioneve të Shitjes, të lirë dhe të pastër nga çdo Barre, në baze të Ligjeve të Aplikueshme ose mënyrë tjetër;

(iv) deklarata të përgjithshme nga të gjithe Drejtorët dhe aksioneri i Shoqërisë që çlirojnë çdo përgjegjësi që Shoqëria ka ndaj tyre, ose çdo pretendim që ata mund të kenë ndaj Shoqërisë bashke me letrat e doreheqjes të nënshkruara nga Drejtori i Pergjithshem, Zv. Drejtoret e Përgjithshëm të Përbashkët dhe të gjithë Drejtorët, që në çdo rast pranojne që ai/ajo nuk ka asnjë pretendim ndaj Shoqërisë për humbje të pozicionit ose ndryshe, me kusht që këto letra dorëheqjesh do të mbahen si garanci nga Blerësit dhe nuk do të behen të efektshme për sjelljen si pasoje të zgjidhjes së kontratës së punës së çdo nënshkruesi derisa Blerësit do të kene dhënë njoftimin e pranimit te doreheqjes së këtij nënshkruesi;

(b) Nëse për ndonjë arsye dispozitat e këtij Seksioni 3.04 nuk përputhen plotësisht, Blerësit bashkërisht mund të zgjedhin (si shtesë dhe pa kufizuar të gjitha të drejtat e tjera në dispozicion të tyre) të prishin këtë Marrëveshje ose të vendosin një date tjetër për Transferimin e cila të jete jo me vone së 31 Dhjetor 2000.

Seksioni 3.05. Garantime të mëtejshme

Çdo Palë kohë pas kohe pas Datës së Transferimit, me kërkesën e ndonjë Pale tjetër dhe pa kompensim të metejshem, do të ekzekutoje dhe jape instrumenta të metejshem të transferimit dhe ngarkimit (si shtesë të atyre të dorëzuara në bazë të Seksionit 3.04) dhe do të kryeje çdo veprim tjetër

të tillë siç mund të kërkoje në mënyre të arsyeshme çdo Pale tjetër për një transferim më efektiv të Aksioneve të Shitjes sipas Seksionit 3.01.

Neni IV
Angazhime pozitive

Seksioni 4.01.Kryerja e Aktivitetit

Ndërmjet datës së kësaj Marrëveshje dhe Transferimit, Shitësi do beje të mundur që Shoqëria të veproje si vijon, perveç kur Blerësit përndryshe do të japin pëlqimin me shkrim:

(a) te kryeje aktivitetin e saj vetem në menyre të zakonshme dhe të evitojë ndryshimin ose hyrjen e çdo metode tjetër të drejtimit ose operimit perveç drejtimit në menyre të zakonshme të aktivitetit dhe në përputhje me praktikat e mëparshme;

(b) te beje perpjekjet e saj me të mira për të penguar çdo ndryshim në lidhje me marrëveshjet e saj me bankat e tjera;

(c) te beje perpjekjet e saj me të mira për të mbajtur të paprekur organizimin e aktivitetit të saj, të ruaje disponueshmerine e zyrtareve aktuale, agjentëve dhe punonjësve (perveç së në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje) dhe të ruaje të drejtat tregtare të te gjithe klienteve, furnizuesve, dhe të tjereve që kane marredhënie pune me te;

(d) te mbaje në fuqi dhe të ruaje gjate gjithe kohes sigurimet e një lloji dhe në një shumë të kenaqshme për Blerësit, dhe me siguruesit e aprovuar prej Blerësve;

(e) te lejoje Blerësit dhe perfaqësuesit e tyre të autorizuar të kenë hyrje të plotë në të gjitha pasuritë, aktivet, të dhënat, të ardhurat e tatueshme, kontratat dhe dokumentat dhe t'u paraqëse Blerësve ose perfaqësuesve të tyre të autorizuar informacion financiar dhe informacione të tjera në lidhje me aktivitetin ose aktivet e saj siç mund të kerkojne Blerësit në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

(f) të krijojë dhe mbajë procedura të brendshme të kënaqshme për Blerësit me qëllim ndalimin e Shoqërisë që të shndërrohet në një instrument për pastrim parash, mashtrime ose qëllime të tjera të korruptuara dhe të paligjshme;

(g) te mbaje auditorë të pavarur të pranueshem për Blerësit dhe t'i autorizoje ata të komunikojnë direkt me Blerësit me shpenzimet e Blerësve;

(h) te marre dhe të kujdeset për plotfuqishmerine e të gjitha Autorizimeve të nevojshme; dhe

(i) te jete në pajtim me të gjitha Ligjet e Aplikueshme përfshirë ligjet bankare dhe kërkesat rregullatore të formuluara nga Banka e Shqipërisë dhe të autorizoje Blerësit të komunikojnë direkt me Banken e Shqipërisë në çdo kohe në lidhje me pajtimin e Shoqërisë me ligjet dhe rregulloret bankare dhe çdo çështje tjetër.

Seksioni 4.02.Riorganizimi i Bilancit

Shitësi bie dakort dhe hyn në marrëveshje me Blerësit që brenda 30 Ditëve Pune nga data e kësaj Marrëveshje (ose ndonjë datë tjetër siç mund ta vendosin Palët) Shitësi do të bëjë që Shoqëria të:

(a) ridenominoje kapitalin aksionar të Shoqërisë në Dollarë;

(b) riorganizojë kapitalin aksionar të Shoqërisë në menyre të tillë që shoqëria të këtë një kapital aksionar të barabarte me shumën prej 10,000,000 US$ dhe ekuivalentin në US$ në datën e ridenominimit të 2,700,000,000 Lekë rrumbullakosur në me të aferten e 10 US$ dhe të ndarë në Aksione të zakonshme të autorizuara me vlerë 10 US$ sejcila nga të cilat 1,000,000 janë autorizuar por nuk janë emetuar dhe pjesa tjetër janë emetuar, paguar plotësisht dhe në pronesi të plote të Ministrise së Financave në emër të Republikës së Shqipërisë ;

(c) regjistroje kapitalin aksionar të Shoqërisë siç është riorganizuar në përputhje me Seksionin 4.02(b);

(d) kaloje kapitalin aksionar të Shoqërisë në Bankën Italo-Shqiptare dhe Bankën Arabo-Shqiptare Islamike në një Ent Shteteror (ose ndonjë ent tjetër të sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshem për Blerësit);

(e) transferoje në një Ent Shteteror (apo ent tjetër të sugjeruar nga Shitesi dhe te pranueshem për Blerësit) Transhin e Pare të Kredise;

(f) pranojë transferimin nga Ministria e Financave, duke pasur parasysh kalimin dhe transferimin e referuar në Seksionin 4.02(d) dhe 4.02(e), të Bonove të Thesarit, vlera e të cilave është rënë dakord nga Palët, të jete 3.5 miliard Lekë;

(g) para ekzekutimit të ndonjërit prej detyrimeve të referuara nga Seksioni 4.02(a) deri në Seksionin 4.02(f), të miratojë të gjitha këto vendime të aksionerëve dhe të Këshillit Drejtues siç kerkohen në baze të Ligjeve të Aplikueshme për tu dhënë efekt ketyre detyrimeve dhe çdo ndryshimi pasues të Statutit duke përfshirë por pa kufizuar ato të bashkëngjitura në Pasqyren A;

(h) regjistroje formën e rënë dakort të Statutit.

Seksioni 4.03. Shkelja e Deklarimeve dhe Garancive

Menjëherë pas ndodhjes, ose menjëherë pasi Shitësi merr dijeni para Transferimit për ndodhjen ose kërcënimin për të ndodhur të një rasti i cili do të shkaktonte ose përbënte një shkelje, ose do të kishte shkaktuar ose perbere një shkelje, ndodhur ose bërë të njohur për Shitësin përpara datës së kësaj Marrëveshjeje, të çdo deklarimi dhe garancie të Shitesit që permbahet ose referohet në këtë Marrëveshje, Shitësi do t'u japë njoftim të detajuar me shkrim të një rasti të tillë secilit prej Blerësve, dhe Shitësi, në masen që do të jete në gjendje ligjerisht, do të beje perpjekjet e tij të arsyeshme për të ndaluar ose kompensuar menjëherë në mënyrën e duhur.

Seksioni 4.04. Pranimi i Transhit të Dyte të Kredise

Shitësi do të bëjë të mundur që një Ent Shteteror (apo një ent tjetër i sugjeruar nga Shitësi dhe i pranueshem për Blerësit) të pranojë transferimin e Transhit të Dyte të Kredise brenda katërmbedhjetë ditëve që nga marrja e njoftimit nga Shitësi per këtë qëllim nga Blerësit. Shitësi do të bëjë të mundur që Enti Shteteror (apo një ent tjetër i sygjeruar nga Shitësi dhe i pranueshem për Blerësit) të pranojë këtë transferim në datën dhe vendin e percaktuar në këtë njoftim me kusht që një date e tillë të jete pas Datës së Transferimit.

Seksioni 4.05.Permbushja e Marrëveshjes

Shitësi do të beje perpjekjet e tij me të mira për të permbushur dhe plotesuar, dhe për të bere që Shoqëria të permbushi dhe plotesoje, të gjitha detyrimet e tyre përkatese sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe do të siguroje, dhe do të beje të mundur që Shoqëria të siguroje të gjitha Autorizimet e nevojshme ose miratimet e saj me qëllim që të përmbushen këto detyrime, për të bërë që transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje të kryhen plotësisht.

Seksioni 4.06.Përshtatja e vlerës së Bonove të Thesarit

Blerësit do të bëjnë të mundur që Shoqëria të udhëzojë auditorët të njoftojne Shoqërinë për Vlerën Kontabël të Pershtatur brenda 30 ditëve nga Data e Transferimit. Në qoftese Vlera Kontabël e Pershtatur është pozitive atehere Blerësit do të bejne të mundur që Shoqëria t'i paguaje Shitesit një shumë të barabarte me tejkalimin e aktiveve ndaj pasiveve. Nëse Vlera Kontabël e Pershtatur është negative atehere Shitësi do ti paguaje Shoqërisë një shumë të barabarte me tejkalimin e pasiveve ndaj aktiveve. Çdo pagese e bere në përputhje me Seksionin 4.06 do të realizohet në formën e Bonove të Thesarit dhe do të behet brenda 14 ditëve nga transferimi nga Shoqëria të Transhit të Dyte të Kredise.

Seksioni 4.07.Taksat

(a) Shitësi do të paguajë ose beje që të paguhen të gjitha taksat e tashme dhe të ardhshme, taksat doganore, komisionet dhe pagesat e tjera të çfaredo natyre, së bashku me çdo interes mbi to dhe penalitete në lidhje me to, tani ose në çdo kohe me pas për t'iu vjele ose të vendosura nga Republika e Shqipërisë, ose çdo Ent Shteteror, ose nga çdo organizate në të cilën Republika e Shqipërisë është anetare në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

(b) Shitesi konfirmon që fitimet nga vleresimi i kembimeve valutore mbi aktivet e denominuara në monedhe të huaj në një shumë të barasvlefshme me kapitalin aksionar dhe rezervat e

Shoqërisë nuk do të jene subjekt i ndonjë forme taksash dhe Shitësi do të siguroje që të gjitha Entet Shteterore t'i trajtojne këto fitime në të njejten menyre.

Seksioni 4.08. Mjedisi, Shëndeti dhe Siguria

Ndërmjet datës së kësaj Marrëveshjeje dhe Transferimit, Shitësi do të beje të mundur që Shoqëria ta kryeje veprimtarine e saj duke pasur kujdesin e duhur për mjedisin dhe shendetin e sigurine publike ashtu si dhe ate profesional dhe në përputhje me rregulloret mjedisore dhe standartet në fuqi në çdo kohe në Republikën e Shqipërisë .

Seksioni 4.09. Detyrimet e Shitesit në Lidhje me Kontestimin

Ministria e Financave do të zevendesoje Shoqërinë ose çdo aksioner ose zyrtar të Shoqërisë si e akuzuar (ose pale tjetër të përgjegjshme ndaj ndonjë gjykate ose Enti Shteteror) në lidhje me të gjitha Kontestimet dhe Shoqëria dhe çdo Blerës në këtë menyre çlirohet nga të gjitha përgjegjësite në lidhje me të gjitha Kontestimet. Për shmangien e dyshimit, çdo përgjegjësi qe i shkaktohet Shoqërise ose çdo zyrtari ose aksioneri te Shoqërisë, në lidhje me Kontestimin në mospermbushje të këtij Seksioni 4.09, do të zhdëmtohet nga Shitësi ne përputhje me Seksionin 8.06.

Seksioni 4.10. Detyrimet e Blerësve në Lidhje me Kontestimin

Nëse nga Blerësit ose Shoqëria ose nga punonjësit e tyre përkatës vihet re ndonjë çështje në lidhje me të cilën Shitësit i lind ose mund t'i lindi ndonjë përgjegjësi sipas Seksionit 4.09, Blerësit do të bejne ose do të bejne të mundur që Shoqëria:

(a) t'i japë njoftim me shkrim Shitesit për një çeshtje të tillë sa me shpejt që të jetë praktikisht e mundur duke specifikuar natyrën e pretendimit në detaje të arsyeshme;

(b) nuk do të bëjë ndonjë pranim të përgjegjësise, marrëveshjes ose të bjerë në kompromis për ose me ndonjë person në lidhje me një çeshtje të tillë pa renien dakort paraprakisht me shkrim të Shitësit (nje marrëveshje e tillë nuk duhet të mbahet ose vonohet në menyre të paarsyeshme); dhe

(c) siç kërkohet në menyre të arsyeshme nga Shitësi me një njoftim me shkrim prej pesë ditësh, t'i jape Shitesit dhe keshilltareve të tij profesionale kopje (me shpenzimet e Shitesit) të llogarive, dokumentave dhe të dhënave në posedim apo nën kontroll të Blerësve ose Shoqërisë të cilat kerkohen në menyre të arsyeshme nga Shitësi per t'i bere të mundur Shitesit dhe keshilltareve të tij profesionale mbrojtjen e pozicionit të Shitesit.

Neni V
Angazhime negative

Seksioni 5.01. Kryerja e Aktivitetit

Ndërmjet datës së kësaj Marrëveshje dhe Transferimit, pervec rastit kur Blerësit perndryshe japin pëlqimin me shkrim, Shitësi do të beje të mundur që Shoqëria të evitoje:

(a) shkaktimin, marrjen persiper ose lejimin e ekzistences së ndonjë Borxhi Financiar të ri me perjashtim të depozitave;

(b) hyrjen në ndonjë marrëveshje ose rregullim sipas të cilit asaj i shkaktohet një detyrim i mundshëm si garantuese ose ndryshe ose në ndonjë mënyrë ose sipas ndonjë kushti, të behet e detyruar për të gjithe ose ndonje pjese të ndonje detyrimi financiar ose detyrimi tjetër të një personi tjetër;

(c) krijimin, regjistrimin ose lejimin për të ekzistuar të ndonjë Barre mbi ndonjë nga Aksionet ose pasurite e saj, të ardhurat ose aktive të tjera, të tashme ose të ardhshme;

(d) hyrjen në ndonjë marrëveshje kembimi perqindjeje interesi ose valute, për opsione mbi përqindjet e interesit ose opsione hibride mbi përqindjet e interesit, për marrëveshje kembimesh valutore "forward" ose çdo marrëveshje tjetër për shmangie risku nga perqindjet e interesit, valuta ose

artikuj ose transaksione derivative të ngjashme;

(e) hyrjen në ndonjë transaksion me ndonjë person perveç kryerjes së zakonshme të aktivitetit, me kushte normale komerciale dhe në marrëveshje mbi baza të hapura e transparente, ose hyrjen në ndonjë transaksioni në baze të te cilit Shoqëria do të paguante me shumë së një çmim të pranueshem për të brenda udhezimeve të aplikueshme sipas Ligjeve të Aplikueshme për çdo blerje, ose do të merrte me pak se çmimi komercial i plotë për produktet ose shërbimet e saj;

(f) hyrjen në ndonjë partneritet, marrëveshje ndarje fitimi apo marrëveshje per pagimin e titujve nga të drejtat e prones intelektuale ose rregullim tjetër të ngjashem sipas së ciles të ardhurat ose fitimet e Shoqërisë jane, ose mund të jene, ndarë me ndonjë person tjetër;

(g) hyrjen në ndonjë kontratë manaxhimi ose rregullim të ngjashëm sipas së ciles aktiviteti ose operimi i saj drejtohen nga ndonjë person tjetër;

(h) formimin ose të paturit e ndonjë Filiali, ose berjen ose lejimin për të ekzistuar të huave ose avancave ndaj, ose depozita me persona të tjere ose investime në ndonjë person apo ndermarrje;

(i) shfuqizimin, ndryshimin ose dhënien e ndonje doreheqje në lidhje me ndonjë dispozite të ndonjë marrëveshjeje në të cilën është palë ose dhënien e pëlqimit për ndonje transferim të ndonje marrëveshjeje nga ndonje pale tjetër e një marrëveshje të tillë.

(j) përveç se në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, bërjen e ndryshimeve, ose lejimin e bërjes së ndryshimeve, të natyrës së aktivit ose operimit të saj ose ndryshimin e natyrës dhe qëllimit të Projektit;

(k) ndërmarrjen ose lejimin e ndonjë bashkimi, konsolidimi ose riorganizimi përveç se në përputhje me këtë Marrëveshje.

(l) regjistrimin e ndonjë ngarkimi, transferimi, Barre ndaj një palë tjetër, mbi ndonjë të drejtë apo interesi në Aksionet;

(m) veprimin apo mosveprimin me ndergjegje në nje menyre që mund ta beje pozitën financiare të Shoqërisë me pak te favorshme sesa në datën e kësaj Marrëveshjeje;

(n) berjen e ndonjë blerjeje, shitjeje apo tjetërsimi të çdo aktivi apo pasurie jashtë rrjedhës normale të aktivitetit, apo marrjen e ndonjë angazhimi për shpenzime në lidhje me ndonjë aktiv kapital;

(o) deklarimin, venien menjane apo pagimin e ndonjë dividendi apo bërjen e ndonjë shpërndarjeje tjetër në lidhje me kapitalin e saj aksionar të autorizuar e të emetuar;

(p) hyrjen në ndonjë kontratë punesimi ose (pervecse, në baze të kësaj Marrëveshje) berjen e ndonjë ndryshimi në kushtet kontraktore apo në shperblimet e pagueshme ose per t'u bere te pagueshme ndaj zyrtareve, punonjesve ose agjenteve te saj;

(q) parapagimin e huave nga aksionerët, zyrtaret apo Drejtorët e saj (nëse ka hua të tilla) apo bërjen e ndryshimeve në kushtet e huamarrjes;

(r) bërjen apo mosberjen e ndonjë veprimi që do të këtë si pasojë anullimin apo berjen të anullueshme të ndonjë police sigurimi të kërkuar sipas Seksionit 4.01(d);

(s) hyrjen në ndonjë kontratë apo angazhim që:

(i) jep një të drejtë qiraje apo të drejta të të tretëve në lidhje me aktivet e saj;

(ii) transferon apo jep ndonjë të drejtë opsioni apo të drejtë para-blerjeje, apo ndonjë menyre tjetër të tjetërsimit të aktiveve të saj;

(iii) jep ndonjë hua;

(iv) hyn në ndonjë marrëveshje qiraje financiare, blerjeje me qira apo ndonjë marrëveshje apo rregullim tjetër për pagesa të vonuara perveç se në kryerjen e aktivitetit normal dhe për një shumë totale prej me pak se US$ 25,000;

(v) hyn në ndonjë marrëveshje apo rregullim për të perfituar me ane të qirase, perdorimin e ndonjë pasurie apo paisjeje të çdo lloji; ose

(vi) jep, lëshon apo shuan ndonjë Barre mbi ndonjërin prej aktiveve të saj;

(n) berjen apo mosberjen, ose shkaktimin ose lejimin e berjes apo të mosberjes të ndonjë veprimi apo gjeje që do të rezultonte (ose mund të rezultonte) në shkeljen e deklarimeve dhe garancive të bera në Seksionin 2.01, Seksionin 2.02 dhe Seksionin 2.03; dhe

(o) perveçse në përputhje me këtë Marrëveshje berjen e ndonjë ndryshimi apo lejimin e berjes së ndryshimeve në kapitalin aksionar të autorizuar ose të emetuar apo në Statut ose dhënien e ndonjë Barre mbi Aksionet.

Neni VI

Kushtet paraprake

Detyrimi i Blerësve për të blere çdo Aksion të Shitjes do të jetë në varesi të plotësimit me pare të kushteve paraprake të përcaktuara në këtë nen VI, në çdo rast të kenaqshme në formë dhe permbajtje për Blerësit, përveç kur nga Bleresit është hequr dore me shkrim.

Seksioni 6.01 Riorganizimi i Bilancit

Shoqëria do të ketë:

(a) ridenominuar kapitalin aksionar të Shoqërisë në Dollare në përputhje me Seksionin 4.02(a);

(b) riorganizuar dhe regjistruar kapitalin aksionar të Shoqërisë në përputhje me Seksionet 4.02 (b) dhe 4.02 (c);

(c) transferuar sipas rregullit dhe në mënyrë të vlefshme pjesëmarrjet në Banken Arabo-Shqiptare Islamike dhe në Banken Italo-Shqiptare në përputhje me Seksionin 4.02(d) dhe të gjitha kerkesat ligjore dhe rregullatore dhe Autorizimet (përfshirë miratimin paraprak të Bankes së Shqipërisë) në lidhje me transferimin në dhe regjistrimin e ketyre aksioneve në emrin e Entit Shteteror (apo të një enti tjetër sugjeruar nga Shitësi dhe të pranueshem për Blerësit) në regjistrat e aksionereve të Bankes Arabo-Shqiptare Islamike dhe të Bankes Italo-Shqiptare duhet të jene permbushur sipas rregullit;

(d) transferuar Transhin e Pare të Kredise në përputhje me Seksionin 4.02(e); dhe

(e) marrë Bonot e Thesarit në përputhje me Seksionin 4.02(f) dhe do të ketë fituar titull pronësie të plotë ndaj tyre në përputhje me Ligjet e Aplikueshme.

Seksioni 6.02. Dokumentet Origjinale

Blerësit duhet të kenë marrë origjinalet e ekzekutuara sipas rregullit të dokumentave të meposhtëm:

(a) Llogarite Financiare të audituara të Shoqërisë të një date jo me parë së tridhjetë ditë (ose date tjetër, të tillë siç mund të bien dakort me shkrim Blerësit) para Datës së Transferimit;

(b) dokumentat e pronësise mbi Tokën dhe Ndërtesat;

(c) Licencen Bankare;

(d) letren për auditorët në formën bashkëngjitur si Pasqyra B-1 ;

(e) vendimin e Gjykates së Tiranes që kerkon regjistrimin e ndryshimeve të Statutit të aprovuara nga vendimet e organeve Shoqërisë të specifikuara në seksionin 4.02(g) në Rregjistrin Tregtar të Gjykates së Tiranes; dhe

(f) letren për Banken e Shqipërisë në formën e bashkengjitur si Pasqyra B-2.

Seksioni 6.03. Statuti.

Blerësit duhet të kene marre kopje të vertetuar të formës së rënë dakort të Statutit (dhe, nëse ka lidhje me te, vërtetime të regjistrimit dhe rregullshmerise) të Shoqërisë sipas rregjistrimit në përputhje me urdhrin e Gjykates së Tiranes të specifikuar në Seksionin 6.02(e).

Seksioni 6.04. Autorizimet e Organeve të Shoqërisë.

Bleresit duhet të kene marre kopje të vertetuara të te gjitha vendimeve të aksionerëve dhe të Këshillit Drejtues të kerkuara në përputhje me Seksionin 4.02(g) dhe të te gjitha vendimeve të tjera të aksionereve dhe të Këshillit Drejtues të nevojshme për ekzekutimin e duhur, dorëzimin dhe permbushjen e kësaj Marrëveshje dhe të Dokumentave të tjera Ndihmese nga Shoqëria dhe Shitësi (sipas rastit).

Seksioni 6.05. Miratimet Bankare

Blerësit duhet të kene marre origjinale të ekzekutuara rregullisht të miratimit të Bankes së Shqipërisë për ceshtjet e meposhtme:

(a) çdo Blerës mban me shumë se 10% të kapitalit aksionar të emetuar të Shoqërisë;

(b) personave që Blerësit propozojne të emërojne si Drejtore;

(c) transferimit të Transhit të Pare të Kredise në përputhje me Seksionin 4.02(e) dhe transferimit të Transhit të Dytë të Kredise në përputhje me Seksionin 4.04;

(d) zvogelimit të kapitalit aksionar të autorizuar të Shoqërisë pas Transferimit në 10 milion US$; dhe

(e) nese kerkohet nga Ligjet e Aplikueshme, kalimit të pjesëmarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabo-Shqiptare Islamike.

Seksioni 6.06. Delegimi i Autoritetit

Blerësit duhet të kenë marrë një kopje origjinale të delegimit të autoritetit Minitrit të Financave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 6.07. Aprovimet Qeveritare dhe të tjera.

Blerësit duhet të kene marre kopje të vertetuara të te gjitha Autorizimeve, miratimeve të kreditoreve, arkivimeve dhe regjistrimeve të nevojshme për ekzekutimin, zbatimin dhe permbushjen e kësaj Marrëveshje dhe të Dokumentave Ndihmese nga Shitësi dhe per transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe Dokumentat Ndihmese dhe sa vijon, secila në formë dhe permbajtje të pelqyeshme për Blerësit do jete në fuqi dhe efekt të plote:

(a) Vendimet e Këshillit të Ministrave; dhe

(b) ligjin nxjerre nga Parlamenti për miratimin e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 6.08. Sigurimi.

Blerësit duhet të kene marre një vërtetim origjinal sigurimi nga shoqëria siguruese ose agjenti i sigurimit të Shitesit që tregon që të gjitha policat e sigurimit e kerkuara në përputhje me Seksionin 4.01(d) janë në fuqi dhe veprim të plote si dhe kopje të noterizuara të te gjitha ketyre policave të sigurimit.

Seksioni 6.09. Emërimet e Agjentit të Procesit.

Konfirmime me shkrim nga agjentët përkates për sherbimin e procesit, të emëruar nga secila prej KFN, KB dhe Shitesit, për pranimin nga ana e tyre të këtyre emërimeve.

Seksioni 6.10. Opinionet Ligjore.

Blerësit duhet të kene marre:

(a) opinionin ligjor të Ministrit të Drejtësise; dhe

(b) opinionin ligjor në Anglisht dhe Shqip të Brosio, Casati e Associati në bashkëpunim me Allen & Overy, adresuar BERZH and KFN në lidhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 6.11. Vlefshmeria e Vazhdueshme e Dokumenteve

Të gjitha marrëveshjet, dokumentat dhe instrumentat e dhena Blerësve në përputhje me nenin VI do të jene në fuqi dhe efekt të plote, dhe të pakushtezuara (me perjashtim të berit të kësaj Marrëveshjeje të pakushtezuar, nëse është kusht i një marrëveshjeje të tillë).

Seksioni 6.12. Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e bera ose të konfirmuara nga Shitësi ne këtë Marrëveshje do të jene të verteta në dhe nga Data e Transferimit me të njejtin efekt sikur këto deklarime dhe garanci të jene

bere në dhe nga kjo date.

Seksioni 6.13. Mosndryshimet e kundërta materiale

Asgjë nuk do të këtë ndodhur që, për mendimin e arsyeshem të Blerësve, mund të këtë një efekt të kundert material në Projekt, në aktivitetin e Shoqërisë, operimet ose gjendjen financiare ose në aftesine e Shitesit për të kryer çdo detyrim të tijin në baze të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 6.14. Pezullimi i Marrëveshjes me BERZH

Këshilli i Guvernatorëve të BERZH-it nuk do të këtë nderprere të drejtën e perfitimit të Republikës së Shqipërisë nga burimet e BERZH-it sipas nenit 8.3 të Marrëveshjes për Krijimin e Bankes Europiane për Rindertim dhe Zhvillim.

Seksioni 6.15. Toka dhe Ndërtesat

Blerësve do t'u vertetohet që Toka dhe Ndërtesat janë në posedimin e pacenuar të Shoqerisë.

Seksioni 6.16. Të Tjera

Blerësit do të kene marre dokumenta dhe opinione ligjore të tjera sipas kerkeses së arsyeshme të Blerësve në menyre që të bejne të efektshem Transferimin në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni VII
Opsioni i Rishitjes

Seksioni 7.01.Njoftimi i Ngjarjes, Rekuperimi dhe Njoftimi i Rishitjes

(a) Ne varësi të Seksionit 7.01(c), në çdo kohe gjate Periudhës së Rishitjes pas ndodhjes së një Ngjarje Rishitjeje, Blerësit do të kene të drejtën t'i dorezojne Shitesit një Njoftim Ngjarjeje, dhe Shitësi do të ketë 30 Ditë Pune nga data e dorëzimit të një Njoftimi Ngjarjeje të tillë, ose ndonjë kohe tjetër të tillë siç do të bien dakort Palët, në dispozicion për ta ndrequr Ngjarjen e Rishitjes. Nese Ngjarja e Rishitjes nuk ndreqet brenda kesaj kohe në pëlqimin e arsyeshem të Blerësve, Blerësit do të kenë të drejtë t'i dorezojnë Shitesit një Njoftim Rishitjeje të perbashket për t'i shitur të gjitha Aksionet e Rishitjes me titull të plote garancie, në Datën e Ekzekutimit, me Çmimin e Rishitjes. Për shmangien e dyshimit, Blerësit nuk do të kene të drejtë të dorezojne një Njoftim Rishitjeje në lidhje me çdo gje që është me pak se 100% e kapitalit aksionar të autorizuar të Shoqërisë në datën e një dorëzimi të tillë;

(b) Në varësi te:

(i) së drejtës së Shitesit për të paraqitur ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje (përfshirë ndonjë mosmarrëveshje me ate që nëse ka ndodhur ndonjë Ngjarje Rishitjeje) në Arbitrazh në përputhje me Seksionin 8.12;

(ii) dispozitave të Seksionit 7.02(a); dhe

(iii) dispozitat e Seksionit 7.06;

me marrjen e një Njoftimi Rishitjeje, Shitësi do të jete i detyruar të bleje Aksionet e Rishitjes në përputhje me këtë Marrëveshje. Shitja e Aksioneve të Rishitjes sipas kësaj Marrëveshjeje përfshin të drejtën e Shitesit për të marre çdo dividend të deklaruar, por akoma të papaguar për Aksionet e Rishitjes.

(a) Blerësit nuk do të kene të drejtë t'i kerkojne Shitesit të bleje asnje Aksion në përputhje me Seksionin 7.01(a) nëse ndonjë Aksion i është transferuar ose emetuar një pale të ndryshme nga KFN, BERZH ose KB në ndonjë kohe pas Datës së Transferimit.

Seksioni 7.02.Transferimi mbi Rishitjen

(a) Me transferimin e Aksioneve të Rishitjes Shitesit në përputhje me Seksionin 7.01, çdo Blerës do t'i deklaroje dhe garantoje Shitesit me shkrim se, në varsi të dispozitave të seksionit 7.04:

(i) Ai ka titull të plote pronesie mbi Aksionet e Rishitjes për tu transferuar prej tij të gjithe prej të cileve janë emetuar në menyre të vlefshme, në qarkullim dhe të paguara plotësisht dhe, së bashku me Aksionet e tjera të Rishitjes, perbejne kapitalin e plote të emetuar, nënshkruar dhe teresisht të paguar të Shoqërisë. Në lidhje me Aksionet e Rishitjes për t'u transferuar prej tij ose për emetimin e Aksioneve shtese të çdo klase apo pershkrimi nuk ka opsione, mundesi riblerjeje nga të trete ose instrumenta të konvertueshme në Aksione apo rregullime të tjera. Asnje person nuk ka ndonjë të drejtë (perveç se si aksioner) për të marre pjese nga fitimet e Shoqërisë. Nuk ka letra me vlerë të tjera të Shoqërisë direkt apo indirekt të konvertueshme në ose të kembyeshme për Aksione;

(ii) Aksionet e Rishitjes për tu transferuar prej tij, kur t'i dorezohen Shitesit, do të jene të autorizuara sipas rregullit, të emetuara në menyre të vlefshme, te paguara plotesisht dhe të lira dhe të pastra nga çdo Barre ose pretendim;

(iii) nuk ka mundësi riblerjeje aksionesh nga të trete, opsione ose të drejta të tjera për të blere ose fituar ose (me perjashtim të te drejtave të para blerjes të përcaktuara në Statut) të drejta para blerjeje në lidhje me emetimin ose shitjen e Aksioneve të Rishitjes për tu transferuar prej tij.

me kusht që, asnjë Blerësi nuk do t'i kerkohet të jape një deklarim ose garanci të tillë që një deklarim apo garanci e tillë është apo do të ishte i pavertete si rezultat i Ngjarjes së Rishitjes si pasoje e së ciles Blerësit kane dorezuar Njoftimin e Rishitjes të aplikueshem.

(b) Ne Datën e Ekzekutimit dhe në Vendin e Ekzekutimit, Shitësi do të bleje dhe paguaje për të gjithe Aksionet e Rishitjes të përcaktuara në Njoftimin e Rishitjes, dhe Shitësi do të paguaje totalisht Çmimin e Rishitjes, në fonde menjehere të disponueshme në Dollare, në llogarinë e percaktuar në Njoftimin e Rishitjes ose siç Blerësit mund të përcaktojne kundrejt dergeses nga Blerësi të dokumentave të tilla ekzekutuara rregullisht të kerkuara për të kryer transferimin e ketyre Aksioneve të Rishitjes të shitura, të lira dhe të pastra nga Barra, detyrime, kushte, zbritje ose mbajtje (per ose në llogari të taksave, nëpermjet ndalesave ose ndryshe).

Seksioni 7.03.Ngjarjet e Rishitjes

Për qëllim të Seksionit 7.01 sejcila nga sa me poshtë do të jete Ngjarje Rishitjeje:

(a) nëse ndonjë vendim perfundimtar i një Enti Shteteror (duke përfshirë, pa kufizuar një Ndryshim në Ligj) zhvlerëson ose i ben sejcilën prej me poshtë të pavlefshme ose të paqënesishme teresisht ose ne nje pjese materiale:

(i) privatizimin e Shoqërisë ose proceduren lidhur me një privatizim të tillë;

(ii) këtë Marrëveshje;

(iii) Nënshkrimin, përfshirë ushtrimin e të drejtave të parablerjes që kane Blerësit

(iv) zgjedhjen e KB sipas procedurave të privatizimit;

(v) blerjen e ose titullin mbi çdo Aksion; ose

(vi) terheqjen e interesave të Shoqërisë në Banken Italo Shqiptare ose Bankën Arabo Shqiptare Islamike;

(b) ndonjë deklarim ose garanci e dhënë ose konfirmuar nga Shitësi ne këtë Marrëveshje do të jete jo korrekt, fals ose i rreme në menyre të tillë që të rezultoje në një ndikim të konsiderueshem të kundert ndaj Shoqërisë ose Aksioneve;

(c) nese nëpermjet një veprimi të një Enti Shteteror (ose një serie veprimesh nga një ose disa Ente Shteterore) (përfshirë, pa kufizuar, një Ndryshim në Ligj) që është diskriminues ne pasoja dhe i motivuar politikisht dhe ka shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të Shoqërisë dhe që nuk është shkaktuar direkt ose menjehere nga neglizhenca ose sjellja e keqe e vullnetshme e Shoqërisë ose ndonjerit prej Blerësve:

(i) Shoqëria ose zyrtaret ose punonjesit e saj ndalohen të kryejne teresisht ose ne nje pjese materiale aktivitetin apo operimin e Shoqërisë;

(ii) nje Drejtor ose çdo zyrtar tjetër ose punonjes i Shoqërisë merr një vendim të ndryshem nga parimet e shendosha të kryerjes së aktivitetit;

(iii) Shoqërisë i kerkohet një shtim i detyruar kapitali, të mbaje raporte financiare, ose të ndermarre detyrime financiare ose fiskale që e bejne operimin e Shoqërisë të paleverdisshem në

aspektin komercial; ose

(iv) ndonjë Blerësi nuk i lejohet riatdhesimi i dividendeve, shumave të shitjeve ose fitimeve të tjera qe rrjedhin nga Aksionet në përputhje me këtë Marrëveshje, ose perndryshe të mos i lejohet të gezoje të drejta të plota pronesie dhe titull të vlefshem ndaj çdo Aksioni.

(d) nese nëpermjet një veprimi të një Enti Shteteror (ose një serie veprimesh nga një ose disa Ente Shteterore) (përfshirë, pa kufizuar, një Ndryshim në Ligj) që është i motivuar politikisht dhe ka shkaktuar demtim të konsiderueshem të Shoqërisë dhe që nuk është shkaktuar direkt ose menjehere nga neglizhenca ose sjellja e keqe e vullnetshme e Shoqërisë ose ndonjërit prej Blerësve:

(i) dënohen, shtetëzohen, bllokohen ose shpronësohen në menyre tjetër, teresia apo një pjese e ndonjë aktivi të Shoqërisë, titulli ndaj një aktivi të tillë ose aktiviteti ose operimi të Shoqërisë përfshirë Token dhe Ndërtesat dhe Aksionet;

(ii) pretendohet ose posedohet kontroll ose kujdestari ndaj teresise apo një pjese të ndonjë aktivi të Shoqërisë, titulli ndaj një aktivi të tillë ose aktiviteti ose operimi të Shoqërisë përfshirë Token dhe Ndërtesat dhe Aksionet;

(iii) fitohet posedimi mbi ndonjë Aksion të Shoqërisë (perveç së kur behet në përputhje me këtë Marrëveshje), ose ndermerret ndonjë veprim për shperndarjen ose prishjen e Shoqërisë;

(iv) tërhiqet, ndryshohet, pezullohet ose përfundohet ndonjë Autorizim dhënë Shoqërisë, ose Shoqërisë nuk i jepet ndonjë Autorizim ku efekti direkt ose indirekt mund të jete ndalimi, moslejimi ose vonimi i Shoqërisë për të kryer aktivitetin e saj normal bankar ose ndonjë Pale për permbushjen e detyrimeve të saj ose ekzekutimin e të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo Dokumenti tjetër Ndihmes, ose kryerjen e aktiviteteve të përfshira në to;

(e) nje shkelje të konsiderueshme e ndonje prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga Shitesi,

me kusht që asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndalojë ose kufizoje Bankën e Shqipërisë në ushtrimin e funksioneve të saj, pushteteve dhe detyrave në lidhje me rregullimin dhe supervizionin e bankave sipas ndonjë Ligji të Aplikueshem, traktati ose marrëveshje nderkombetare dhe ushtrimi i ketyre funksioneve, pushteteve ose detyrimeve të Bankes së Shqipërisë nuk do të perbeje një veprim të tipit të referuar në paragrafin e pare të Seksionit 7.03 (c) dhe me kusht që Seksioni 7.03 (d) nuk do të aplikohet për ndonjë veprim (ose seri veprimesh) nga Banka e Shqipërisë që ka konfiskimin si qëllim primar.

Seksioni 7.04. Detyrimet e Shitesit

Shitësi:

(a) pranon se është i detyruar në menyre të pakushtëzuar të paguaje plotësisht Çmimin e Rishitjes në përputhje me këtë Marrëveshje;

(b) pranon së në lidhje me një transferim të Aksioneve të Rishitjes detyrimi i tij për të paguar Çmimin e Rishitjes nuk do të ndikohet nga ai dhe do të mbarte rrezikun e të mos qënurit të Aksioneve të Rishitjes të regjistruara ose nga Qëndra e Regjistrimit të Aksioneve ose nga ndonjë regjistrues i pavarur ose të çdo të mete në formën e çdo transferimi ose refuzimit nga Qëndra e Regjistrimit të Aksioneve ose ndonjë regjistruesi të pavarur për të njohur transferimin apo çdo fakt tjetër apo rrethane që nuk është shkaktuar nga deshtimi i Blerësve në lidhje me këtë transferim i cili mund të privoje Shitesin nga gezimi i plote ose i pjesshem i perfitimit të te drejtave që rrjedhin ose që synohet të rrjedhin nga Aksionet e Rishitjes;

(c) bie dakort që asnje veprim ose mosveprim përfshirë por pa kufizuar ndonjë konsolidim, bashkim, likuidim, shperndarje, rikonstruksion ose riorganizim, kufizim ligjor, pamundesi ose mungese kompetencash apo autoriteti të shoqërive ose rrethana të tjera te, apo çdo ndryshim në perberjen apo identitetin e shoqërive ose humbjen e identitetit të shoqërive nga Shoqëria ose çdo person tjetër nuk do të cenoje detyrimet e tij sipas kësaj Marreveshjeje;

(d) bie dakord se nëse kerkohet ndonjë Autorizim paraprak sipas Ligjeve të Aplikueshme për të bere të efektshem një shitje të parashikuar nga një Njoftim Rishitjeje, Shitësi do beje të mundur që ky Autorizim të sigurohet pa vonese; dhe

(e) pranon se të drejtat dhe detyrimet e një Blerësi sipas kësaj Marrëveshjeje mund t'i kalohen, pjeserisht apo teresisht, një Blerësi tjetër në përputhje me Seksionin 8.15 dhe në të njejten kohe i ngarkuari i lejuar i Blerësve do të këtë të drejtën, midis të tjerave t'i kerkoje Shitesit të bleje ndonjë Aksion të blere nga ndonjë Blerës tjetër në përputhje me këtë Marrëveshje.

Seksioni 7.05. Çmimi i Rishitjes

Çmimi i Rishitjes do të jete:

(a) nëse Data e Ekzekutimit ndodh para se Blerësit të fitojne titullin e plote të pronesise mbi Aksionet e Nënshkrimit, atëhere shpenzimet e Blerësve per te dhene Njoftimin e Rishitjes dhe transferimin e Aksioneve të Rishitjes tek Shitesi; ose

(b) nëse Data e Ekzekutimit ndodh pasi Blerësit kane fituar titull të plote pronesie mbi Aksionet e Nënshkrimit, atehere shuma e rënë dakort ndërmjet Blerësve dhe Shitesit, ose me mospermbushjen e Marrëveshjes me e larta e:

(i) shumës së barabarte me:

(A) Çmimin e Blerjes minus Pagesat e Dividenteve të llogaritura në menyre gjysem-vjetore me Perqindjen e Rishtitjes, të llogaritur mbi bazen e vitit me 360 ditë dhe numrin aktual të ditëve në Periudhën përkatese të Llogaritjes nga Data e Llogaritjes perkatese deri në Datën e Ekzekutimit; dhe

(B) koston e arsyeshme të Blerësve për dërgimin e Njoftimit të Rishitjes dhe transferimin e Aksioneve të Rishitjes Republikës së Shqipërisë; dhe

(ii) shumës së barabarte me:

(A) Vlerën Kontabël; dhe

(B) koston e arsyeshme të Blerësve për dergimin e Njoftimit të Rishitjes dhe transferimin e Aksioneve të Rishitjes Republikës së Shqipërisë .

Seksioni 7.06. Detyrimet e Blerësve

Bleresit nuk do të ndryshojne kapitalin aksionar të Shoqërisë në çdo kohe pas datës së dorëzimit të një Njoftimi Rishitjeje në qofte se, si rezultat i një ndryshimi të tillë, Shitësi blen me pak se 100% të kapitalit aksionar të autorizuar të Shoqërisë në Datën e Ekzekutimit.

Neni VIII

Të ndryshme

Seksioni 8.01. Marrëveshja e Plotë; Ndryshimet dhe dorëheqja

Kjo Marrëveshje dhe dokumentat e referuara në këtë Marreveshje perbejne detyrimin e plote të Palëve në lidhje me objektin e saj dhe do të zevendesoje çdo shprehje të qëllimit ose mirekuptim të meparshem në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim, ose heqje dore nga Blerësit për ndonjë nga kushtet dhe afatet, ose pëlqim i dhënë nga Blerësit në bazë të kësaj Marrëveshje (duke përfshirë, pa kufizuar, këtë Seksion) do të paraqitet me shkrim, nënshkruar nga Blerësit dhe, në rastin e ndonjë ndryshimi, nga Blerësit dhe Shitesi. Shitësi njeh që duke rënë dakord të hyje në këtë Marrëveshje ai nuk është mbeshtetur në ndonjë përfaqësim, garanci ose kontrate kolaterali apo siguri të tjera.

Seksioni 8.02.Njoftimet

Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që do të jepet ose behet nga çdo Pale në baze të kësaj Marrëveshje, do të jete me shkrim. Me perjashtim të rastit kur percaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, njoftimi, aplikimi ose tjetër komunikim do të konsiderohet të jete dhënë ose bere sipas rregullave kur është dhënë dorazi, me poste ajrore, ose faks Pales te ciles i kerkohet ose lejohet t'i jepet ose behet në adresen e kesaj Pale te specifikuar me poshtë ose në ate adrese tjetër që kjo Pale ia percakton me ane të një njoftimi Pales që jep ose ben njoftimin, aplikimin ose komunikimin tjetër te tille.

Për Shitësin:

Ministria e Financave e RSH
Bul. Dëshmoret e Kombit
Tiranë

Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Fax: 355 42 284 94

Për BERZH:

European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Njësisë Administrative të Operimit
Fax: (44) (20) 7338-6100

Për KFN:
International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 U.S.A.

Në vëmendje të: Drejtorit, Departamentit për Europën Jugore dhe Azinë Qëndrore
Fax: (202) 974-4314
(202) 974-4317

Për KB
Kent Bank A. S.
Askerocagi Cad.15
80200 Elmadag, Stamboll
Republika e Turqise

Në vëmendje të: Drejtorit të Pergjithshem
Fax: (90) 212 274 89 20

Seksioni 8.03. Gjuha Angleze

Të gjitha dokumentat për t'u paraqitur ose komunikimet për tu dhënë ose bere në baze të kësaj Marrëveshje do të jene në gjuhen Angleze ose, nëse janë në ndonjë gjuhe tjetër, do të shoqërohen nga një perkthim në Anglisht i vërtetuar në emër të Shitesit, si perkthim që do të jete versioni percaktues ndërmjet Palëve.

Seksioni 8.04. Llogaritjet Financiare

Të gjitha llogaritjet financiare që do të bëhen në bazë te, ose për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të behen në përputhje me Parimet Pergjithesisht të Pranuara të Kontabilitetit dhe, siç mund të kërkohet ndryshe për të qëne konform dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të behen duke perdorur Llogarite Financiare tre mujore me të fundit të Shoqërise, me kusht qe nese Llogarite Financiare përkatese tre-mujore nuk janë audituar, me deshiren e Blerësve, Llogarite e tjera Financiare te audituara mund të perdoret për këtë llogaritje financiare.

Seksioni 8.05.Te Drejtat, Rregullimet Ligjore dhe Heqjet

(a) të drejtat dhe rregullimet ligjore të çdo Pale ("Pala e Pare") në lidhje me ndonjë deklarim jo të vertete ose shkelje të garancive nga ana e një Pale tjetër ("Pala e Dyte") nuk do të paragjykohen nga ndonjë hetim nga ose në emër të Pales së Dyte në çeshtjet e Pales së Pare ose Shoqërisë, nga ekzekutimi ose përmbushja e kësaj Marrëveshje, ose nga ndonjë akt ose gje tjetër që mund të jete bere

nga ose në emër të Pales së Dyte në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që mund, pavaresisht nga ky Seksion, të paragjykojë këto të drejta dhe rregullime ligjore.

(b) asnjë menyrë veprimi ose heqje dore nga ndonjë Palë ose Shoqëria në lidhje me ndonje kusht të kësaj Marrëveshjeje nuk do të demtoje të drejtat, kompetencat ose rregullimet e kompensimet ligjore të kësaj Pale në lidhje me kushte të tjera ose nuk do të interpretohet si heqje dore prej ketyre kushteve të tjera.

(c) asnjë menyrë veprimi dhe asnje vonese në ushtrim, ose mosushtrim, i të drejtave, kompetencave ose rregullimeve ligjore që i shtohen një Pale në lidhje me ndonjë permbushje të detyrimeve në baze të kësaj Marrëveshje ose ndonjë Dokumenti Ndihmes, ose, marrëveshje tjetër nuk do të demtojne këto të drejta, kompetenca ose rregullime ligjore ose nuk do të interpretohen si heqje dore prej tyre ose si pranim në heshtje i tyre. Asnje ushtrim i vetem ose i pjesshem i ketyre të drejtave, kompetencave ose rregullimeve ligjore nuk do të pengoje ushtrimin e metejshem të tyre ose të te drejtave, kompetencave ose rregullimeve ligjore të tjera. Asnje veprim i ndonjë Pale në lidhje me një mosplotësim të tillë ose pranim në heshtje prej tij të tyre, nuk do të ndikoje ose demtoje të drejtat, kompetencat ose rregullimet ligjore të një Pale të tillë në lidhje me mosplotësime të tjera.

(d) çdo heqje dore nga ndonjë Pale ose ndonjë shkelje e ndonjëres prej deklarimeve, garancive, angazhimeve ose kushteve të përmbajtura në këtë Marrëveshje, ose ndonjë Dokument Ndihmes tjetër ose lehtesim tjetër i së njejtes ose ndonjë inkurajim i dhënë në çdo kohe nga një Pale e tillë, pa ndonjë shprehje të rezervuar ndaj atij, do të konsiderohet të jete i paparagjykuar ndaj, dhe nuk do të ndikoje ushtrimin në çdo kohe me pas nga një Pale e tillë të te gjitha ose ndonjëres prej të drejtave të tyre sipas kesaj Marrëveshjeje, sikur të mos ishte bere një doreheqje e tillë ose lehtesim ose inkurajim;

(e) të drejtat dhe rregullimet ligjore të dhena në këtë marrëveshje jane kumulative dhe jo ekskluzive ndaj të drejtave dhe rregullimeve të tjera ligjore, nëse parashikohen ne ligjet e aplikueshme ose jo me kusht që;

(i) ushtrimi i çdo të drejte të Blerësve sipas Seksionit 7.03 (b) do të jete për zgjidhjen e plote dhe perfundimtare të çdo pretendimi që Blerësit mund të kene ndaj Shitesit në lidhje me një shkelje të deklarimeve dhe garancive dhënë nga Shitësi sipas Seksionit 2.01, Seksionit 2.02 ose Seksionit 2.03; dhe

(ii) nëse ndonjë Blerës ka ngritur një pretendim të konsiderueshem të suksesshem në lidhje me nje mospermbushje te ndonje deklarimi ose garancie sipas Seksionit 2.01, Seksionit 2.02 ose Seksionit 2.03, Blerësit nuk do të jene në gjendje të ushtrojne ndonjë të drejtë sipas Seksionit 7.03 (b) ku shkelja e deklarimit dhe garancise e cila perndryshe do të ishte pretenduar sipas Seksionit 7.03 (b) u shkaktua nga të njejtat rrethana të cilat rezultuan në këtë pretendim të konsiderueshem të suksesshem. Me qëllim të këtij Seksioni 8.05 (e) (ii), një "pretendim i konsiderueshem i suksesshem" do të thotë një vendim dhënie demtimesh në lidhje me një shkelje deklarimi ose garancie që tejkalon US$ 100,000.

(f) Për shmangien e cdo dyshimi, Blerësit do të mbajne të gjitha të drejtat dhe rregullimet ligjore në dispozicion të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas ligjit perveç sic eshte rene dakort me shkrim ndermejt Blerësve dhe Shitesit.

Seksioni 8.06. Dëmshpërblimi

Shitësi merr përsipër përgjegjësi të plote, dhe bie dakort dhe do të dëmshpërbleje dhe do ta ruajë te paprekur sejcilin prej Blerësve dhe Shoqërinë ndaj dhe për çdo ose të gjitha përgjegjësite, detyrimet, humbjet, demtimet (kompensuese, ndeshkimore ose të tjera) gjobat, pretendimet, veprimet, taksat, detyrimet, paditë, kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë, pa kufizuar, kuotat dhe shpenzimet ligjore të pranueshme të këshilltarëve dhe kostot e shpenzimet e hetimeve) të çdo lloji dhe natyre, duke përfshirë, pa paragjykuar përgjithshmerine e sa me siper, ato që rezultojne në kontrate ose dem jashtekontraktor (duke përfshirë, pa kufizuar, neglizhencen) ose ato me përgjegjësi strikte ose menyra të tjera, të cilat u janë ngarkuar, janë pesuar ose u jane njohur Blerësve ose Shoqërisë (te demshperblyer ose jo nga çdo person tjetër në baze të çdo dokumenti tjetër) dhe që ne ndonje menyre lidhen me to ose rezultojne nga ato, direkt ose indirekt:

(a) çdo transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje ose Dokumentat Ndihmese ose

ekzekutimi, zbatimi ose përmbushja e kësaj Marrëveshjeje ose dokumentave;

(b) posedimi i lire ose pronesia, ose kontrolli i Tokes dhe Ndërtesave nga Shoqëria;

(c) ushtrimi nga Blerësit i çdo të drejte dhe rregullimi të tyre ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë prej Dokumentave Ndihmese; ose

(d) çdo pretendim ose kontestim i rrethanave ose shkaktimi veprimi që del para Datës së Transferimit nese ky problem ishte i ditur apo duhet të ishte bere i ditur Shitesit në kohen e Transferimit.

Seksioni 8.07.Vazhdimësia e Dëmshpërblimit

E drejta e Blerësve për tu zhdemtuar nga Shitësi ne përputhje me këtë Marrëveshje do të ekzistoje dhe vazhdojë deri sa të gjitha parate e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje do të jene paguar pavaresisht nga çdo shlyerje e llogarive ose zvogelim apo ripagese e shumës se detyrueshme për momentin dhe do të jenë në shtim të dhe nuk do të paragjykohen në ndonjë mënyre ose preken, ose në ndonjë menyre paragjykojne ose prekin, ndonje kolateral, sigurim ose zhdemtim tjetër të krijuar nga Shitësi ne favor të Blerësve.

Seksioni 8.08. Interesi i pagesës së Vonuar

Pa paragjykuar rregullimet e disponueshme ndaj çdo Pale sipas kësaj Marrëveshjeje ose perndryshe:

(a) nese ndonjë Pale nuk arrin të paguaje në afat ndonjë shumë qe duhet paguar nga ajo në baze të kësaj Marrëveshjeje, pagesa jo në afat do të grumbulloje interes në një perqindje të barabarte me shumën e:

(i) 2.0% në vit;

(ii) Perqindjen Ndërbankare

(b) interesi do te:

(i) rrjedhe ditë për ditë gjate gjithe një Periudhë Llogaritjeje;

(ii) perllogaritet në numrin e ditëve të kaluara realisht dhe mbi baze të një viti me 360 ditë;

(iii) perllogaritet në baza gjashte mujore; dhe

(iv) do të jete në kohe dhe i pagueshem sipas kerkeses.

Seksioni 8.09.Taksat

Asnjë taksë nuk do vihet mbi fitimin (nese do të ketë) të realizuar nga BERZH ose KFN në lidhje me një shitje të Aksioneve të transferuara nga BERZH ose KFN. Asnje takse (përfshirë taksat e pulles), tatime, komisione, ose detyrime të tjera të pagueshme mbi ose në lidhje me, ekzekutimin, leshimin, levrimin, regjistrimin, ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje ose shitjen, transferimin ose levrimin e Aksioneve Rishitjes të transferuara nga BERZH ose KFN në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe çdo dokument lidhur me to nuk do të vendosen nga ndonjë Ent Shteteror, megjithate me kusht që për sa kohe nuk do të vendoset një takse, tatim, komision apo tjetër lloj pagese e këtij tipi, kjo shumë do të ngarkohet direkt mbi dhe do të paguhet direkt nga Ministria e Financave pa ndonjë pagese apo rimbursim të kësaj shume nga BERZH dhe KFN.

Seksioni 8.10. Bashkëpunimi

(a) Republika e Shqipërisë do të beje perpjekjet e saj me të mira për tu permbajtur nga çdo veprim, nëse objekti apo efekti i një veprimi të tillë do të kufizonte apo pengonte shitjen, transferimin ose disponimin e çdo Aksioni nga Blerësit; dhe nëse është e nevojshme, Republika e Shqipërisë dhe Blerësit do të bashkepunojne plotësisht për të siguruar lejet dhe heqjet e kerkuara për të realizuar këtë shitje, transferim ose disponim të çdo Aksioni nga Blerësit.

(b) Palët bien dakort që, nëse ndonjë dispozite e Statutit në çdo kohe është në konflikt me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë do të ushtroje të gjitha kompetencat dhe të drejtat e disponueshme prej saj për të ndihmuar në ndryshimin e Statutit nga Shoqëria në masen e nevojshme për të lejuar rregullimin e Shoqërisë dhe aktiviteteve të saj siç parashikohet në këtë

Marrëveshje.

(c) Çdo Pale do të ekzekutoje të gjithe ato dukomenta dhe instrumenta të tillë të tjere dhe do të beje të gjitha ato veprime dhe gjera të tilla siç mund të percaktojne Palët e tjera si të nevojshme ose të deshirueshme për të realizuar dispozitat e Transferimit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.11. Ligji Qeverisës

Kjo marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Anglise dhe të Wellsit.

Seksioni 8.12. Arbitrazhi dhe Juridiksioni

(a) Çdo mosmarrëveshje, polemike ose pretendim që rezulton nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose me prishjen, perfundimin ose pavlefshmerine e saj, do të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrimit UNCITRAL që janë aktualisht në fuqi. Do të ketë një arbiter dhe autoriteti emërues do të jete Gjykata e Arbitrazhit Nderkombetar të Londres. Vendi i arbitrimit do të jete Londra, Angli dhe gjuha angleze do të perdoret gjate gjithe procedurave të arbitrazhit. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë në baze të Aktit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose ndryshe nga apelimi i çdo arbitrimi të caktuar, ose nga kerkimi i percaktimit të një pike paraprake të ligjit, nga gjykatat e Anglise. Gjykata e arbitrazhit nuk do të jete e autorizuar të marre ose të siguroje dhe Shitësi nuk do të jete i autorizuar të kerkoje nga ndonjë autoritet gjyqësor, masa paraprake mbrojtjeje ose perjashtim të paracaktuar ndaj Blerësve, pavaresisht nga dispozitat e Rregullave UNCITRAL të Arbitrimit. Gjykata e arbitrazhit do të këtë kompetencen të konsideroje dhe të përfshije në çdo procedure, vendim ose caktim çdo mosmarrëveshje të mëtejshme të paraqitur tek ajo sipas rregullave nga ndonjë Pale për aq sa kjo mosmarrëveshje rezulton nga ndonjë Dokument Ndihmes, por, në varesi të sa me siper, asnje pale tjetër ose mosmarrëveshje tjetër nuk do të përfshihet ose konsolidohet në procedurat e arbitrimit. Në çdo procedure arbitrimi, vërtetimi i Blerësve për çdo shumë që iu detyrohet Blerësve në baze të kësaj Marrëveshjeje ose çdo Dokumenti Ndihmes, do të jete evidence prima facie e kësaj shume.

(b) Pavaresisht nga Seksioni 8.12(a), kjo Marrëveshje dhe Dokumentat Ndihmese dhe çdo e drejtë e Blerësve që rezulton nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose çdo Dokument Ndihmes sipas deshires së Blerësve mund të ekzekutohet nga Blerësit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë ose në ndonjë gjykate tjetër kompetente. Për perfitim të Blerësve, Shitësi paraqet në menyre të parevokueshme në juridiksionin jo-ekskluziv të gjykatave të Anglise dhe Republikës së Shqipërisë në lidhje me çdo mosmarrëveshje, polemike ose pretendim që rezulton nga ose në lidhje me këtë Marrëveshjeapo çdo Dokumenti Ndihmes, ose prishjen, perfundimin ose mosvlefshmerine e saj ose të tyre. Shitesi, KFN dhe KB në menyre të parevokueshme caktojne, emërojne dhe i japin fuqi të veproje personit të percaktuar në Seksionin 8.19 të veproje si agjenti i tyre i autorizuar për marrjen e sherbimeve të procesit gjyqësor dhe të çdo thirrjeje ligjore tjetër në Angli për qëllimin e çdo veprimi dhe procedure ligjore të hapur nga Blerësit në lidhje me këtë Marrëveshje. Shitësi ne menyre të parevokueshme jep pëlqimin e tij për sherbimin e procesit gjyqësor ose për çdo thirrje tjetër ligjore nga këto gjykata duke dërguar kopje të tij me poste ajrore rekomande të parapaguar në adresen e tij të paraqitur këtu. Shitësi merr persiper dhe bie dakort që, për aq kohe sa ai ka detyrime në baze të kasaj Marrëveshje, ai do të mbaje një agjent të emëruar sipas rregullave për marrjen e sherbimeve të procesit gjyqësor dhe të çdo thirrje tjetër në Angli për qëllimin e çdo veprimi dhe procedure ligjore të hapur nga Blerësit në lidhje me këtë Marrëveshjedhe do të mbaje në dijeni Blerësit për identitetin dhe vendndodhjen e këtij agjenti. Asgje e permendur këtu nuk cenon të drejtën e Blerësve të fillojne veprime ose procedura ligjore kunder Shitesit sipas menyrave të autorizuara nga legjislacioni i juridiksionit përkates. Fillimi nga Blerësit i veprimeve ose procedurave ligjore në një ose me shumë juridiksione nuk do të pengoje Blerësit nga fillimi i veprimeve ose procedurave ligjore në çdo juridiksion tjetër, njekohesisht ose jo. Shitësi ne menyre të parevokueshme heq dorë nga çdo kundershtim që mund të këtë tani ose këtëj e tutje ndaj çdo problemi çfaredoqofte mbi çfaredo baza për vendosjen e vendit të zhvillimit të gjyqit dhe çdo pretendim qe mund te ketë tani ose këtëj e tutje që ky veprim ose procedure ligjore është hapur në një instance të papershtatshme.

Seksioni 8.13. Privilegjet dhe Imunitetet e BERZH dhe KFN

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si heqje dore, braktisje ose modifikim tjetër i çdo imuniteti, privilegji ose perjashtimi të BERZH-it të akorduar në përputhje me Marrëveshjen për Krijimin e Bankes Europiane për Rindertim dhe Zhvillim, konventen nderkombetare ose çdo ligj të aplikueshem dhe të KFN-se sipas Neneve të Marrëveshjes së saj, konventes nderkombetare ose çdo ligji të aplikueshem.

Seksioni 8.14. Heqja dorë nga Imuniteti

Shitësi (ne të gjithe hapesiren ligjore që ia lejojne Ligjet e Aplikueshme) në menyre të parevokueshme dhe të pakushtezuar:

(a) bie dakord që ekzekutimi, kryerja dhe përmbushja prej tij e kësaj Marrëveshje, perben me tepër veprime private dhe tregtare;

(b) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ai ose pasurite e tij kane ose që mund të fitoje pas datës së kësaj Marrëveshjeje në lidhje me procedura ligjore të ngritura kunder tij ose aktiveve të tij në lidhje me këtë Marrëveshje nga Blerësit ose Shoqëria dhe/ose nga të ngarkuarit e tyre përkates;

(c) bie dakord që asnje imunitet nga këto procedura (që do të gjykohen të përfshijne, pa kufizuar, padi, sekuestro para gjykimit, sekuestro tjetër, marrjen e gjykimit, ekzekutimin apo tjetër menyre të venies në ekzekutim) nuk do të pretendohet nga ose ne emer të tij apo në lidhje me pasurite e tij; dhe

(d) jep pëlqimin në pergjithesi në lidhje me këto procedura për dhënien e ndonjë lehtesie ose për hapjen e ndonjë procesi në lidhje me këto procedura duke përfshirë, por pa kufizuar, berjen, detyrimin ose ekzekutimin kunder çdo pasurie çfaredo qofte (pamvaresisht nga perdorimi i saj ose qëllimi i perdorimit) të ndonjë urdhri apo gjykimi që mund të jete bere ose dhënë në këto procedura.

Seksioni 8.15. Pasuesit dhe të Ngarkuarit

Secila prej palëve ka të drejtë të ngarkoje ose transferoje të drejtat dhe detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe kjo Marreveshje do të detyroje dhe do të hyje në veprim për perfitim të pasuesve dhe të te ngarkuarve përkates të Palëve, me perjashtim se Republika e Shqipërisë do të këtë të drejtë ngarkoje ose transferoje me pëlqimin paraprak me shkrim të Blerësve. Për shmangien e dyshimit dhe në përputhje me Seksionin 7.01 (c) dhe Seksionin 7.06, perveç rastit të transferimit ose ngarkimit të ndonjë Aksioni një Blerësi tjetër, çdo ngarkim dhe transferim i çdo Aksioni nga ndonjë Blerës do të rezultoje në perfundimin e të drejtës së Blerësve (përfshirë çdo transferues ose të ngarkuar të te drejtave sipas kesaj Marrëveshjeje) për t'i kerkuar Shitesit të bleje çdo Aksion në përputhje me nenin VII.

Seksioni 8.16. Zbulimi

Çdo Palë mund të zbuloje dokumenta, informacion dhe të dhena të tilla që kane të bejne me çdo Palë tjetër dhe këtë transaksion (duke përfshirë, pa kufizuar, kopje të çdo dokumenti) siç mund ta konsideroje të arsyeshme Pala zbuluese në lidhje me çdo mosmarrëveshje që përfshin këtë Marrëveshje ose Dokumentat Ndihmese me qëllim ruajtjen e çdo të drejte të Palës zbuluese në baze të kësaj Marrëveshje ose ndonjë Dokumenti Ndihmës.

Seksioni 8.17. Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në disa kopje, ku secila prej tyre do të gjykohet si kopje origjinale, por të gjitha ato së bashku do të perbejne një dhe të njejten Marrëveshje.

Seksioni 8.18. Ndarja e Klauzoles

Dispozitat e permbajtura në çdo Seksion dhe paragraf të kësaj Marrëveshje do të jene të detyrueshme pavaresisht nga njera-tjetra dhe vlefshmeria e tyre nuk do të ndikohet nëqoftese njera perj tyre është e pavlefshme. Nëqoftese njera prej ketyre dispozitave është e pavlefshme por mund të jete e

vlefshme nëqoftese ndonjë pjese e dispozites hiqet, dispozita në fjale do të aplikohet me këtë modifikim siç mund të jete e nevojshme për ta bere të vlefshme.

Seksioni 8.19. Agjentët e Autorizuar të Procesit

Per Shitesin: Ambasada e Republikës së Shqipërisë
Kati I dyte
24 Buckingham Gate
London SW1 E6LB
Angli

Per KFN: Korporata Financiare Nderkombetare
4 Millbank
London SW1P 3JA
Angli

Per KB: Z.Ilhan Nebioglu
Kleinwort Benson Ltd.
9 Grosvenor Square
London W1X 9LB
Angli

Seksioni 8.20 Të drejtat e palëve të treta

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim të preke ndonjë të drejtë të një personi jo Pale dhe Akti i Kontratave (Te drejtat e palëve të treta) 1999 nuk do të aplikohet per këtë Marrëveshje.

NË DËSHMITË SA ME SIPËR, Palët që veprojne nëpermjet perfaqësuesve të tyre të autorizuar sic duhet, bejne nënshkrimin e kesaj Marrëveshjeje ne emrin e tyre përkates në datën e shkruar me siper.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: Emri: Anastas Angjeli
Titulli: MINISTRI I FINANCAVE I REPUBLIKËS SE SHQIPERISË

BANKA EUROPIANE
PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM

Nga: Emri: Charles Frank
Titulli: I deleguar si President, BERZH

KORPORATA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Nga: Emri: Peter L. Woicke
Titulli: Zv/President Ekzekutiv, KFN

KENT BANK A. S

Nga: Emri: Mustafa Suzer
Titulli: Kryetar i Kent Bank

PASQYRA A - PROCES-VERBAL I ASAMBLESË SE JASHTEZAKONSHME TË AKSIONERËVE TE BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SH.A.

Në vitin 2000 në ditën • të muajit • në oren • u mbajt në zyrat e Shoqërisë në •, Tirane, asambleja e jashtezakonshme e aksionereve të Bankes Kombetare Tregtare ("Shoqëria") për të diskutuar sa me poshtë:

RENDI I DITËS

(1) Miratimi i ridenominimit dhe ri-organizimit të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

(2) Miratimi i kalimit të pjesemarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike tek •; miratimi i tranferimit tek • i transhit të pare të kredive të Shoqërisë në shumën totale prej • ("Kreditë"); dhe miratimi i transferimit tek Shoqëria nga Ministria e Financave, si kundershperblim për këtë kalim dhe transferim, të një numri prej • bonosh thesari në shumën totale prej 3.5 miliarde Lekë dhe me një vlerë nominale prej • Lekë secila ("Bonot e Thesarit") dhe miratimi dhe autorizimi për të nënshkruar, dorezuar dhe permbushur të gjitha të drejtat e detyrimet e Shoqërisë nën [percakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike, transferimin e Kredive dhe transferimin e Bonove të Thesarit].

(3) Çështje të tjera përfshire:

(a) Miratimin e ndryshimeve në Statutin e Shoqërisë në menyre që të beje disa ndryshime të nevojshme.

(b) Identifikimi i nënshkruesve të autorizuar të [përcakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike dhe transferimin e Bonove të Thesarit];

(c) Miratimi i formës së Çertifikates së Aksionit të Shoqërisë dhe rregjistrimi i Aksioneve në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve.

* * *

• thirret që të drejtoje këtë mbledhje të jashtezakonshme të aksionereve. Kryetari fton Z. • të veproje si sekretar. Kryetari i mbledhjes verteton gjithashtu se • është i pranishem.

Kryetari verifikon dhe njeh se aksioneret e meposhtëm, që perfaqësojne të gjithe kapitalin aksionar të Shoqërisë, janë të pranishem në mbledhje:

• Kryetari atehere deklaron së pjesemarrja në mbledhje është sipas rregullit dhe ka fuqine që të miratoje rezoluta për të gjitha çeshtjet e rradhitura në Rendin e Ditës:

(1) Kryetari, në baze të raportit të tij ashtu si edhe në raportin e ekspertit kontabël të miratuar dhe miratimin paraprak të Bankes së Shqipërisë, propozon të miratoje ridenominimin e propozuar të kapitalit aksionar të Shoqërisë në US Dollare (US$) dhe riorganizmin e propozuar të kapitalit aksionar të Shoqërisë keshtu që Shoqëria ka një kapital aksionar të barabarte me shumën prej US$ 10,000,000 dhe ekuivalentin në US$ në datën e [kesaj rezolute] prej 2,700,000,000 Lekë të rrumbullakosur në me të aferten e US$ 10 dhe të ndarë në aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 10 US$ secili prej te cileve nga 1,000,000 prej ketyre aksioneve do të jene të autorizuar por të paemetuar dhe mbetja ("Aksionet e Shitjes") do të jene emetuar, në qarkullim, të paguar plotësisht dhe në pronesi të Shitesit.

Pas një diskutimi të thelle, aksioneret unanimisht

Miratuan

ridenominimin e propozuar të kapitalit aksionar të Shoqërisë dhe riorganizimin e propozuar të kapitalit aksionar të Shoqërisë keshtu që Shoqëria ka një kapital aksionar të barabarte me shumën prej US$ 10,000,000 ekuivalent në datën e [kesaj rezolute] me 2,700,000,000 Lekë të rrumbullakosur në me të aferten e US$10 secila prej të cileve secili nga 1,000,000 prej ketyre aksioneve do të jene të autorizuar por të paemetuar dhe mbetja ("Aksionet e Shitjes") do të jene emetuar, në qarkullim, të paguar plotësisht dhe në pronesi të Shitesit.

(1) Kryetari, në baze të raportit të tij dhe në baze te raportit te ekspertit kontabël të miratuar dhe miratimin paraprak të Bankes së Shqipërisë , propozon të miratohet kalimi i propozuar i pjesemarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike ("Anetaret") tek •; të miratoje transferimin tek • të kredive të tilla që kur i shtohen vlerës së pjesemarrjeve në Anetaret arrijne 3.5 miliard Lekë; të miratoje transferimin tek Shoqëria nga Ministria e Financave të Bonove të Thesarit, si kundershperblim për kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike dhe të transferimit të Kredive, te Bonove te Thesarit dhe të miratoje dhe autorizoje për të nënshkruar, dorezuar dhe permbushur të gjitha të drejtat e detyrimet e Shoqërisë nën [percakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë ne Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike, transferimin e Kredive dhe transferimin e Bonove të Thesarit].

Pas një diskutimi të thelle, aksioneret unanimisht

Miratuan

Kalimin e propozuar të pjesemarrjeve të Shoqërisë në Banken Italo-Shqiptare the Banken Arabe-Shqiptare Islamike tek •; transferimin tek • të Kredive; dhe transferimin tek Shoqëria nga Ministria e Financave, si kundershperblim për këtë kalim dhe transferim, të Bonove të Thesarit dhe nënshkrimin, dorëzimin dhe permbushjen e propozuar të te gjitha të drejtave e detyrimeve të Shoqërisë nën [percakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike, transferimin e Kredive dhe transferimin e Bonove të Thesarit].

3(a) Kryetari informon Aksioneret që është e nevojshme të ndryshohen disa nene të Statutit të Shoqërisë siç janë bashkengjitur në Pjesen B.

Pas një diskutimi të thelle dhe shqyrtimi të Marrëveshjeve përkatese, aksioneret unanimisht

Miratuan

Te gjithe ndryshimet në Statutin e Shoqërisë siç është percaktuar në Pjesen B.

3(b) Kryetari u propozon Aksionereve të japin plotfuqishmerine për të nënshkruar [percakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike dhe transferimin e Bonove të Thesarit], në emër të Shoqërisë •, ose në mungese të tij/saj, •

Pas një diskutimi të thelle, Aksioneret unanimisht

Miratuan

•, ose në mungese të tij/saj, • të gjitha plotfuqishmerite për të nënshkruar [percakto emrat e Marrëveshjeve që duhet të nënshkruaje BKT në lidhje me kalimin e pjesemarrjeve të Shoqërisë ne Banken Italo-Shqiptare dhe Banken Arabe-Shqiptare Islamike, dhe transferimin e Bonove të Thesarit], në emër të Shoqërisë.

3(c) Kryetari propozon qe Shoqeria te ndaloje se leshuari çertifikata aksionesh ne leter dhe te gjitha aksionet e Shoqërisë te regjistrohen tek Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve e themeluar nën Ligjin Nr.8108 e datës 28 Mars 1996 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.112 të datës 19 Shkurt, 1996.

Pas një diskutimi të thelle, aksioneret unanimisht

Miratuan

që Drejtori i Pergjithshem dhe zv.Drejtori i Pergjithshem janë të autorizuar bashkarisht që të anullojne çertifikatat ekzistuese te aksioneve dhe te regjistrojne te gjitha aksionet e Shoqerise në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve të themeluar sipas Ligjit Nr.8108 të datës 28 Mars 1996 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.112 të datës 19 Shkurt, 1996, dhe

U japin

Drejtorit të Pergjithshem dhe Zv.Drejtorit të Pergjithshem autorizimin për të bere gjithe kerkesat e nevojshme në menyre që të gjithe aksionet e Shoqërisë të regjistrohen në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve.

Kryetari informon aksioneret që mbi çeshtjet që duhet të vendoseshin me vendim të mbledhjes së jashtezakonshme të aksionereve është marre vendim dhe fton Z./Znj. • Noter Publik, të verifikoje titullin dhe plotfuqishmerite e personave që ndoqën këtë mbledhje të jashtezakoshme të aksionereve në emër të aksionereve dhe të vërtetoje që vendimet e mesiperme janë marre në menyre të vlefshme dhe azhornon mbledhjen e zakonshme të aksionereve në • [a.m./p.m.] me •, 2000.

KRYETAR	SEKRETAR
Z./Znj.	**Z./Znj.**

PASQYRA B - 1 – FORMA E LETRËS PER AUDITORËT

[Të shtypet me kokën e Letrës së Shoqërisë]

[Data]

[Emri i Auditorëve]

[Adresa]

Zoti/Zonja:

Ne ju autorizojme dhe kerkojme t'i jepni Korporates Financiare Nderkombetare ("KFN"), Bankes Europiane për Rindertim dhe Zhvillim ("BERZH") dhe Kent Bank ("K.B.") të gjithe informacionin që çdonjëri prej tyre mund të kerkoje në lidhje me Llogarite tona Financiare, të audituara ose jo.

Ne ju autorizojme t'u dergoni llogarite tona të audituara KFN-se, BERZH-it dhe KB-se. Kur t'i jene paraqitur këto llogari të audituara KFN-se, BERZH-it dhe KB-se, ne ju kerkojme gjithashtu të dergoni, në të njejten kohe, një kopje të raportit tuaj të plote për këto llogari në një formë të pranueshme për KFN, BERZH dhe KB.

Per regjistrimet tona, ju lutem siguroni që të na dergoni edhe në një kopje të çdo letre që merrni nga KFN, BERZH dhe KB menjehere pas marrjes dhe një kopje të çdo pergjigjeje të dhënë nga

ju menjehere pas dhënies së saj.

I juaji,
Banka Kombetare Tregtare

Nga:_____
Perfaqësuesi i Autorizuar:

cc: European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Drejtuar: Njesise Administrative të Veprimit
Lenda: Nr. i Operimit [_____]

cc: International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 U.S.A.
Drejtuar: [Drejtorit, Departamentit për Europen Qendrore dhe Jugore]
Lenda: Numri i Operimit [_____]

cc: Kent Bank AS
Askerocagi Cad 15
80200 Elmadag, Istambul,
Turqi

Ne vemendje: Drejtorit te Pergjithshem

PASQYRA – B - 2 FORMA E LETRËS PER BANKËN E SHQIPËRISË

[Të shtypet me kokën e Letrës së Shoqërisë]

[Emri i Autoritetit Rregullator Bankar]

[Adresa]

Zoteri/Zonje

Në përputhje me kushtet e një marreveshjeje blerje aksionesh datë [_____] ("Marreveshja e Blerjes së Aksioneve") ndërmjet Republikës së Shqipërisë , Bankes Europiane për Rindertim dhe Zhvillim("BERZh"), Koorporates Financiare Nderkombetare ("KFN") dhe Kent Bank A.S. ("KB"), ju kerkojme dhe autorizojme t'i jepni BERZH, KFN dhe KB të gjithe ato informacione që çdonjëri prej tyre mund të kerkoje në menyre të arsyeshme në lidhje me të qënurit tone në përputhje me me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme të aktivitetit bankar të Republikes së Shqipërisë .

Ju kerkojme që të na dergoni për të dhenat tona një kopje të çdo letre që ju keni marre nga BERZH, KFN dhe KB menjehere pas marrjes dhe një kopje të çdo pergjigjeje bere nga ju menjëhere pas dergimit.

Juaji sinqerisht

Nga:_____
Firma e Autorizuar

Cc: European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Drejtuar: Njesise Administrative të Operimit
Lenda: Operacioni Nr. 82

Cc: International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 U.S.A.
Drejtuar: [Drejtorit, Departamentit për Europen Jugore dhe Azine Qendrore]
Lenda: Investimi Nr. 9687

Cc: Kent Bank A. S.
Askerocagi Cad.15
80200 Elmadag, Istanbul
Turqi

Ne vemendje:Drejtorit te Pergjithshem

PASQYRA C- PROCES VERBAL I MBLEDHJES SË AKSIONERËVE TË BKT

Ne vitin 2000 në ditën e – të muajit – në oren ---, takimi i jashtezakonshem i BKT (Shoqëria) u mbajt në zyrat e Shoqërisë në Tirane për të diskutuar sa me poshtë:

RENDI I DITES:

(1) Aprovimin dhe autorizimin për të hyre në një marrëveshje Nënshkrimi midis Shoqërisë, BERZH, KFN dhe KB, ("Marreveshja e Nenshkrimit") në lidhje me nënshkrimin nga aksioneret ekzistues të aksioneve të mbetura prej 1,000,000 të autorizuara por të paemetuara të Shoqërisë në proporcion me aksionet e tyre ekzistuese në baze të Marrëveshjes së nënshkrimit dhe aprovimit të nënshkrimit.

(2) Miratimin e transferimit të transhit të dyte të kredive të Shoqërisë për një shumë totale prej – (Kreditë shtese).

(3) Miratimin e reduktimit të kapitalit aksioner të Shoqërisë në 10 milion USD.

(4) Miratimin dhe autorizimin për të hyre në një marrëveshje Sponsorizimi dhe Garancie midis Shoqërisë, KB, BERZH, KFN dhe SuzerHolding (SH), në lidhje me sigurimin e financimit në rrethana të caktuara ("Marreveshja e Sponsorizimit dhe Garancise"); miratimin e Deklarates së Politikes së Operimit.

(5) Çështje të tjera përfshirë:

(a) Miratimin e dorëheqjes të anetareve të Bordit të Drejtoreve dhe Komitetit Auditor;

(b) Miratimin e emërimit të anetareve të rinj të Bordit të Drejtoreve dhe Komitetit të Auditorëve;

(c) Miratimin e emërimit të një firme kontabël me reputacion nderkombetar si eksperti kontabël i vertetuar i Shoqërisë;

(d) Miratimin e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë në menyre që të ndryshohet kapitali i autorizuar, i nenshkruar dhe i paguar;

(e) Regjistrimi i Aksioneve në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve që reflekton reduktimin e kapitalit të Shoqërisë;

(f) Percaktimi i periudhës së nënshkrimit në lidhje me nënshkrimin e aksioneve të Shoqërisë dhe heqjen dorë nga të drejtat e parablerjes të aksionereve ekzistues në lidhje me nënshkrimin e propozuar të aksioneve të Shoqërisë sipas Marrëveshjes së nënshkrimit, BERZH, KFN, dhe KB; dhe

(g) Identifikimin e firmave të autorizuara të Marrëveshjes së Nënshkrimit, Certifikates së

Pagesës (se referuar në Marrëveshjen e Nënshkrimit) dhe Marrëveshjen e Sponsorizimit dhe Garancise.

-- thirret të kryesoje takimin e jashtezakonshem të aksionereve. Kryetari fton z.—si sekretar. Kryetari verifikon se – gjithashtu është prezent.

Kryetari verifikon dhe njeh se Aksioneret e meposhtëm, perfaqësues të teresise se kapitalit askionar të autorizuar dhe paguar të Shoqërisë, janë prezent në takim:

- Kent Bank, përfaqësuar nga
- BERZH, përfaqësuar nga
- KFN përfaqësuar nga

Kryetari deklaron që takimi është bere sic duhet dhe ka fuqine të miratoje të gjithe rezoultat dhe ceshtjet e dhena në rendin e ditës:

(1) Kryetari propozon miratimin dhe autorizimin për të hyre në një Marrëveshje Nënshkrimi midis Shoqërisë, BERZH, KFN dhe KB, në lidhje me nënshkrimin e pjeses së mbetur prej 1,000,000 aksione të autorizuara por të panënshkruara në Shoqëri (Marrëveshja e Nënshkrimit) dhe nënshkrimit të propozuar (Nënshkrimi) të aksioneve nga KB, BERZH dhe KFN të një shumë totale 1 milion Aksione te zakonshme të autorizuar dhe të paemetura te Shoqerise në proporcionet: KB (60%), BERZH (20%) dhe KFN (20%) me vlerë nominale 10$ secili, për një shumë totale baraz me 10 milion USD.

Pas një diskutimi të plote dhe rishikimit të Marrëveshjes perkatese, që i ishte dhënë aksionereve 15 ditë para datës së këtij takimi, aksioneret unanimisht

Miratuan

hyrjen nga Shoqëria në një Marrëveshje Nënshkrimi dhe Nenshkrimin nga BERZH, KFN dhe KB në shumën dhe për çmimin e nënshkrimit të treguar me siper.

(1) Kryetari bazuar në [raportin e tij dhe të kontabilistit të vertetuar], propozon të aprovoje transfermin e Kredive Shtese tek – në baze të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve të datës – midis RSH, BERZH, KFN dhe KB, hyrjen në këtë marrëveshje sic është miratuar në mbledhjen e jashtezakonshme të aksionereve të Shoqërisë në –

Pas diskutimeve, aksioneret, unanimisht

Miratuan

Transferimin e propozuar të kredive --, në shumën dhe termat e kushtet e referuara në Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve.

(1) Sipas Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve, Kryetari propozon të aprovohet reduktimi i propozuar i kapitalit aksionar të Shoqërisë në shumën 10 milion USD duke reduktuar respektivisht aksionet e secilit aksioner, si rezultat i humbjeve të Shoqërisë në shumë totale – lek, të evidentuara nga një raport në dispozicion të aksionereve dhe depozituar të Drejtori i Pergjithshem i Shoqërisë në {sheno datën që do të jete të pakten 15 ditë para datës së takimit} dhe me raport të kontabilistit të vertetuar të Shoqerise së datës {sheno datën të pakten 15 ditë para datës së takimit} duke ndjekur dorëzimin e lajmerimit nga Shoqëria të kontabilistit të vertetuar në ose përpara [sheno datën të pakten 45 ditë para takimit].

Pas një diskutimi te thelle, aksioneret unanimisht:

Miratuan

sipas nenit 164 të ligjit 7638 të 19 nëntorit 1992, reduktimin e propozuar të kapitalit aksioner të Shoqërisë në 10 milion USD, duke reduktuar proporcionalisht aksionet e secilit aksioner, si rezultat i humbjeve të Shoqërisë në shumën totale prej --- lek.

(1) Kryetari propozon miratimin dhe autorizimin për të hyre në Marrëveshjen Sponsorizuese dhe të Garanacise midis Shoqerise, BERZH, KFN, KB dhe SH, në lidhje me sigurimin e financimit në situata të caktuara. Në baze të marrëveshjes të Blerjes së Aksioneve, Kryetari propozon të miratoje Deklaraten e Poltikes së Operimit.

Pas një diskutimi te thelle, Aksioneret unanimisht

Miratuan

hyrjen në një Marrëveshjen e Sponsorizimit dhe Garancise nga Shoqëria dhe miratuan Deklaraten e Politikes së Operimit si politike e Shoqërisë.

(1) (a) Kryetari i jep Aksionereve për miratim doreheqjet e – dhe – si anetare të Bordit të Drejtoreve [me efekt të menjehershem], dhe doreheqjen e – si anetare të Komitetit auditor.

Pas shqyrtimit të Aksioneret unanimisht

Miratuan

dorëheqja e – dhe – si anetare të Bordit të Drejtorëve, dhe – si anëtarë të Komitetit auditor dhe njohjen që individet e mesiperm kane hequr dorë nga kompensimi për detyren e tyre si anetare të Bordit të Drejtoreve ose si anetare të Komitetit Auditor dhe nuk kane pretendime ndaj Shoqerise.

(5) (b) Kryetari i jep Aksionereve, sipas Marrëveshjes së aksionereve, propozimin për të emëruar – dhe – si anetare të Bordit të Drejtoreve sic janë emëruar nga BERZH, KFN dhe KB [me efekt të menjehershem mbi bazen që BSH të këtë miratuar emërimin ne-] e – dhe – si anetare të Komitetit Auditor.

Pas konfirmimit të emërimeve të nevojshme, aksioneret unanimisht

Miratuan

emërimin e – dhe – si anetare të Bordit të Drejtoreve dhe – si anetare të Komitetit Auditor.

(5) (c) Kryetari i jep aksionereve propozimin për të emëruar – dhe – si kontabiliste shqiptare të regjistruar.

Pas vlerësimit të propozimeve dhe diskutimeve te thella, aksioneret unanimisht

Miratuan

-- si auditorë ndërkombetarë të Shoqërisë dhe – si auditorë shqiptare.

(5) (d) Kryetari informon Aksioneret së është e nevojshme të ndryshohet neni 6 i Statutit të Shoqërisë në menyre që të reduktohet kapitali i autorizuar dhe i emetuar në 10 milion USD për të reflektuar kapitalin e ri të autorizuar të Shoqërisë në përputhje me rezoluten e dhënë në piken 3 me siper. Për këto qëllime, Kryetari i propozon Aksionereve që neni 6 i Statutit të Shoqërisë te ndryshohet si me poshtë.

"Neni 6
Kapitali

Kapitali i autorizuar aksionar i Bankes është 10 milion USD dhe kapitali i autorizuar dhe i emetuar i Bankes është 10 milion USD.

Kapitali i autorizuar ndahet në 1 milion aksione të së njejtes kategori me vlerë nominale 10 USD për aksion.

[Aksionet e autorizuara numerohen nga 1 në 1 milion duke përfshirë të fundit]"

Pas një diskutimi aksioneret unanimisht

Miratuan

amendamentin e nenit 6 të Statutit te Shoqërisë në lidhje me reduktimin e kapitalit aksioner të Shoqërisë.

(5) (e) Kryetari propozon të regjistroje të gjithe aksionet e Shoqërisë në Qendrën e Regjistrimit te Aksioneve të krijuar me ligjin 8108 të datës 28 Mars 1996 dhe VKM nr. 112 date 19 Shkurt 1996.

Pas diskutimit aksioneret unanimisht

Miratuan

regjistrimin e te gjithe aksioneve të Shoqërisë në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve të krijuar sipas ligjit nr. 8108 date 28 Mars 1996 dhe VKM nr. 112 date 19 Shkurt 1996, dhe

i japin

Drejtorit të Pergjithshem dhe Zv/drejtorit autoritetin për të dërguar aplikimin për regjistrimin e aksioneve në Qendër.

(5) (f) Kryetari propozon, bazuar në raportin e Bordit të Drejtoreve dhe Kontabilistit, që KB heq dorë sipas nenit 156 të ligjit 7638 të datës 19 nentor 1992 nga të gjithe të drejtat e parablerjes në lidhje me nenshkrimin e 2 aksioneve sipas Marrëveshjes së Nënshkrimit në favor të KFN dhe BERZH. Kryetari propozon që aksioneret do të kene të drejtën të nënshkruajne për aksione brenda periudhës së nënshkrimit duke filluar në – dhe mbaruar --. Për me tepër, Kryetari propozon që aksioneret ekzistues të Shoqërisë të heqin dorë nga të drejtat e refuzimit të pare [ne zbatim te nenit 207 te ligjit nr.7638 date 19 nentor 1992 dhe nenit 11 te Statutit] në lidhje me Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve dhe Marrëveshjes së Rishitjes dhe Riblerjes midis KB, BERZH, dhe KFN.

Pas diskutimit, aksioneret unanimisht

Miratuan

heqjen dorë nga Kent Bank nga të drejtat e parablerjes në lidhje me nënshkrimin e 2 aksioneve të Marrëveshjes së Nënshkrimit në favor të BERZH dhe KFN dhe heqjen dorë nga të gjithe të drejtat e refuzimit të pare në lidhje me Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve dhe Marrëveshjen e Rishitjes dhe Riblerjes, dhe

Miratuan

që aksioneret do të kene të drejtën të nënshkruajne aksionet brenda periudhës së nënshkrimit që fillon në – dhe mbaron në --.

(5) (g) Kryetari propozon që aksioneret të japin të drejtën për të nënshkruar Marrëveshjen e Nenshkrimit, Certifikaten e Pagesës të referuar në Marrëveshjen e Nënshkrimit dhe Marrëveshjen e Sponsorizimit dhe Garancise në emër të Shoqërisë, -- , ose në mungese të tij nga --.

Pas diskutimit, aksioneret vendosen unanimisht

t'i japin

-- te gjithe të drejtat për të nënshkruar Marrëveshjen e Nënshkrimit, Certifikaten e Pagesës të referuar në Marrëveshjen e Nënshkrimit dhe Marrëveshjen e Sponsorizimit dhe Garancise në emër të Shoqërisë.

Kryetari informon Aksioneret që çeshtjet për t'u zgjidhur me vendim të mbledhjes së jashtezakonshem të aksionereve janë zgjidhur dhe fton Z. – noter, për të verifikuar titullin dhe të drejtat e personave që ndoqën këtë mbledhje ne emer te aksionereve, të vertetoje që këto vendime janë marre vlefshmerisht dhe e deklaron takimin të mbyllur.

Kryetari Sekretari